



**DISA BIDATE TË PËLQYERA
NË KOHË TË SAHABEVE**



HIXHRETI – FILLIMI JONË!



**MUNDENI SHEJTANIN,
MUNDENI PARAGJYKIMIN
E SHOQËRISË..!**

Viti XIV - Nr. 9 (163),
Shtator, 2016

Botim i Myftinisë Shkodër

UDHA ISLAME

*E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative*

NE MUSLIMANËT, NUK KEMI PASUR NDONJËHERË KOMPLEKSE NGA DIVERSITETI FETAR!



Frymën e harmonisë ndërfitare e kemi ushqyer me shpirtin tonë prej shekujsh,
do të vazhdojmë ta bëjmë duke respektuar fenë e secilit, kulturën e tij,
lirinë dhe përzgjedhjen e lirë. Do të vazhdojmë të punojmë, që harmonia
të mbetet vlerë mbi vlerat, por në të njëjtën kohë, do të tërheqim vëmendjen
ndaj çdo tendence, me a pa qëllim, që tenton të prishë këtë ekuilibër të shenjtë,
për të cilin do të japim llogari para Zotit, fillimisht, por edhe para brezave që vijnë!



Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

Të gjitha falënderimet e plota dhe madhështia absolute i takojnë vetëm All-llahut të Madhëruar, i Cili i bëri ditët e Haxhit dëshmi të pashembullt të madhështisë së teuhidit, uniteti në mesin e muslimanëve dhe reflektim për të parë secili në veten e tij dhe në shoqërinë e tij, ekuilibrat e fesë, moralit, energjisë për mirë dhe shpejtimin drejt ndërtimit në jetë.

Salavatet dhe selamet më të përzemërta ia dërgojmë sot, në këtë ditë dhe në çdo ditë të jetës sonë, dritës së syve, mallit të zemrës, frymëzimit të shpirtit, ma të Mirit, zotërisë së bijve të Ademit, ndërmjetësuesit në ditën e gjykimit, Hz. Muhammedit (a.s), të dërguarit mëshirë për mbarë botrat, i cili thotë: “Ai që e bën Haxhin, pa shkelje e pa gjynahe, do të kthehet si ditën që e ka lindur nëna e tij” – [Bukhariu dhe Muslimi, nga Ebu Hurejra (r.a).]

Dhe thotë poashtu: “Nuk ka ditë, ku All-llahu liron prej robëve të Tij nga zjarri, më shumë sesa në ditën e Arefatit. Ai zbret pranë tyre, pastaj mburret me ta para melekëve dhe u thotë: Çfarë kërkojnë këta?” – [Muslimi, nga nana e jonë Aishe (r.a).]

Dhe thotë poashtu: “Nga Umreja në Umre fshihen gjynahet në mes tyre, ndërsa Haxhi i mbarë nuk ka shpërblim tjetër veç xhennetit!” – [Bukhariu dhe Muslimi, nga Ebu Hurejra (r.a).]

Dhe thotë poashtu: “Pasojeni Haxhin me Umre, sepse vazhdimësia në mes tyre i fshin gjynahet, si zjarri ndryshkun e hekurit!” – [As’habus-Sunen, përveç Ebu Davudit, nga Omeri (r.a).]

Dhe thotë poashtu: “Do të vijë ky Gur (Guri i Qabes) në ditën e kiametit, me dy sy, me të cilët do të shohë dhe me një gjuhë, me të cilën do të flasë, do

MUNDENI SHEJTANIN, MUNDENI PARAGJYKIMIN E SHOQËRISË..!

të dëshmojë për këdo që e ka prekur me të drejtë!” – [Ibn Maxheh, nga Ibni Abbasi (r.a).]

Dhe thotë poashtu: “Prekja e atyre të dyve (Gurit dhe Rukni Jemanit), fshin gabimet” – [Tirmidhiu, nga Ibni Omeri (r.a).]

Dhe thotë poashtu: “Rukni dhe Mekami janë dy xhevahire prej xhevahireve të xhennetit dhe, sikur All-llahu të mos ia kishte shuar dritën e tyre, do të kishin ndriçuar në mes lindjes dhe perëndimit!” – [Tirmidhiu, nga Ibni Abbasi (r.a).] Etj.

TË DASHURIT E MI,

Mirë se ju gjeta, pas kthimit nga Haxhi i sivjetshëm, ku rreth 40 vetë prej vëllezërve dhe motrave tua, iu bashkuan karvaneve nga mbarë bota në dëshminë më madhështore të besimit dhe dashnisë ndaj All-llahut, në vendet e shenjta; Mekë e Medine.

All-llahun e Madhëruar e falënderojmë pa fund që e desht fort Shkodrën e Shqipërinë dhe nga mesi i këtij populli, që përpëlitet sot, në momentet më dramatike të historisë së tij kombëtare, zgjodhi me qindra delegatë, për të vizituar Shtëpinë e Tij, për t’ua falur gjynahet, për të kërkuar falje e bërë lutje, për të vizituar Resulull-llahun (a.s) e për t’i dhënë selam, për të dëshmuar bukurinë dhe mrekullitë e fesë islame në bashkësinë më të përzgjedhur të vitit! Për të shijuar madhësitë e fjalës YMMETI ISLAM, por jo vetëm!

TË DASHURIT E MI,

Kam mendur gjatë, atje dhe këtu, sesa mirësi e madhe është të jesh musliman! Nuk ka mirësi më të madhe në jetë! Nuk ka as pasuri, as miradi, as mirëqenie, asgjë prej gjëje, që krahasohet me këtë mirësi, që ruan ekuilibrat e krejt mirësive në jetë.

Më lejoni të sjell ca shembuj. U ngjitem në Hira, ku edhe macet e bekuara qëndronin me besnikëri në gjurmët e Resulull-llahut (a.s). Ndoshta atë dashuri që Zotëria i jonë shprehu ndaj tyre, sa ishte në këtë botë, ata

e ruajtën për Pejgamberin tonë, deri në kiamet, njësoj si trugu i hurmës, deveja, guri e druri, Uhudi e krejt krijesat që e deshtën dhe u përmalluan për të...

Mendova, sikur të ishte sot, në mesin tonë Resulull-llahu (a.s) dhe të na pyeste për besimin, fenë tonë, veprat tona, familjet tona, detyrimet ndaj Thirrjes

*Mendova, sikur
të ishte sot, në mesin tonë
Resulull-llahu (a.s)
dhe të na pyeste
për besimin, fenë tonë,
veprat tona, familjet tona,
detyrimet ndaj
Thirrjes Islame,
përkrahjen e nevojtarëve,
ruajtjen e moralit
dhe nderit, frenimin
nga haramet dhe
mekruhatet në jetë etj.,
etj., çfarë do i thonim?*

Islame, përkrahjen e nevojtarëve, ruajtjen e moralit dhe nderit, frenimin nga haramet dhe mekruhatet në jetë etj., etj., çfarë do i thonim?

Mendova, mbi 1200 shkallë të gurta të ç’rregullta për t’u ngjitur drejt Hirasë. Zotëria i jonë është ngjitur pa këto shkallë, në kërkim të Zotit, logjikës së fesë, shpirtit dhe ngrohtësisë së tij. Sot, i kemi para duarve; Kur’anin, Hadithet, Shembullin e përkryer të Hz. Muhammedit (a.s), pa pasur nevojë të ngjitemi nëpër male e shpella, pa vështirësi e pa ndrojtje, por sa jemi muslimanë në të vërtetë? Sa jemi përvetësues të këtyre mësimëve, praktikantë të tyre, përhapës të tyre tek të tjerët, që shoqëria e jonë të bëhet përditë e më shumë muslimane,

■ ÇFARË E PENGON
MUSLIMANIN E SOTËM
SHKODRAN
E ATË SHQIPTAR
PËR TË RUAJTUR GJUHËN,
MENDIMET, VEPRIMET,
PËR TË LËNË HARAMET,
PËR T’U DIVORCUAR NGA
JETA PA BESIM
DHE RUTINA E MBUSHUR
ME FODULLËK

■ E MUNGESË LARMIE?!

optimiste, krenare, pastërtore, urtake, e ditur, e qytetëruar...

Mendova, gjatë Haxhit, të gjithë mundohemi të ruhem nga ndonjë fjalë e tepërt, nga bisedat e kota të kësaj bote, deri edhe mizën s’e trazojmë, as mushkonjën, që na pickon, as fijen e barit s’e lëndojmë, vështirimet i kontrollojmë, mendimet i qetësojmë, transformohemi në njerëz të bardhë, me rroba të bardha, me mendime të bardha, me fjalë të bardha. Pse të mos e mbajë gjithësecili prej nesh besën e Haxhit edhe në Shkodër, në Shqipëri, kudo në botë?! Pse të ms jemi HAXHI, sa të jemi gjallë?

Ishim mbi dy milionë nga mbarë bota. Ndoshta edhe më shumë. Vetëm buzëqeshje. Vetëm dëshirë për të ndihmuar. Vetëm dëshirë për të bërë mirë, deri edhe me një gotë uji zemzemi a një shishe uji të ftohtë, deri edhe me një pecetë për të fshirë djersët, deri edhe me një hurmë të vogël, një biskotë, një kafshatë buke... Nuk dëgjuam asnjëherë fjalën “terror”, as “vrasje”, as “grabitje”, as “shpërthime”, as “thyerje të simboleve fetare joislame”, as “shkelje e poshtërimit të drejtave të jomuslimanëve”, asnjëherë! Të ishim ndryshe, edhe mund t’i dëgjonim e mund t’i thonim e ndanim me të tjerët me shumë krenari, por jo, ne nuk jemi veçse MUSLIMANË DHE JEMI KRENARË PËR FENË DHE PÛRKATËSINË TONË!

TË DASHURIT E MI,

Çfarë e pengon muslimanin e sotëm shkodran e atë shqiptar për të mësyer derën e xhamisë? Përse brezi i djegur nga kolera ateisto-komuniste heziton të kthehet nga Zoti, me pretekstin se nuk di asnjë sure e nuk di si falet namazi? Po pse, kush prej nesh ka ditur? Kush prej nesh di sa e si duhet, realisht?

O të dashur, mos ia privoni vetes mrekullinë e Dashnisë së Tij, e cila kur depërton në zemrën e njeriut e zbkuron dhe e dritëson atë! E bën njeriun melek, që ha dhe pi, që jeton jetën i nënshtruar para vullnetit të Hakut!

Çfarë e pengon muslimanin e sotëm shkodran e atë shqiptar për të ruajtur gjuhën, mendimet, veprimet, për të lënë haramet, për t’u divorcuar nga jeta pa besim dhe rutina e mbushur me fodullëk e mungesë larmie?!

Ndërkohë, në fillim të kësaj hytbeje përmenda një mori hadithesh të sakta, që nxisin kryerjen e Haxhit dhe Umres. I përmenda me qëllim në këtë hytbe të parë pas kthimit nga vendet e shenjta.

Bëjeni nijet qysh sot, sapo të dilni nga xhamia, që vitin tjetër të kryeni Haxhin a të paktën një Umre dhe, nisni e kurseni e grumbulloni nga hallalli juaj, sa të keni mundësi! Pas çdo namazi lutuni për këtë qëllim fisnik! Vallahi, do ju japë Zoti mbarësi dhe do ju ndihmojë në nijetin tuaj.

Resulull-llahu (a.s) thoshte: “Ai që don të kryejë Haxhin le të shpejtojë, sepse mund të sëmuret i sëmuri, mund të humbasë mjetin e mund t’a mbulojnë nevojat!” – [Ibn Maxheh, nga Ibni Abbasi (r.a).]

Ndërkohë, thoshte: “... Haxhiu dhe ai që bën Umren, janë delegatët e All-llahut, i ka ftuar dhe i janë përgjigjur, i janë lutur dhe i është përgjigjur!” – [Ibn Maxheh, nga Ibni Omeri (r.a).]

Mundeni shejtanin, mundeni paragjykimin e shoqërisë, mundeni nefsin dhe çdo pengesë, që ju del para nijetit të pastër për të përfutur këto mirësi të papërshkrueshme e të pakrahasueshme besimi! All-llahu jua mundësoftë që vitin tjetër të jeni prej Haxhive të Shkodrës! Edhe unë me ju! Amin, amin, amin!

Shkodër, më 23 shtator 2016

(Hytbeja e mbajtur
në xhaminë e “Dy Vajzave”)



"Sa herë të shohësh

një njeri

që kundërshton

All-llahun e Madhëruar,

dije se, dikush e ka ditur

të vërtetën dhe ka

neglizhuar të thërrasë

drejt saj!

Kur të shohësh

një të shthurrur,

kërkoji falje All-llahut;

ndoshta, gjynahu

i tij është i lidhur

me neglizhencën tënde!"

Sheikh Ahmed Rastaj



Sheikh Muhamed El-Gazali

Amjafton një eksperiencë e vetme për të zbuluar natyrën e njeriut dhe vendimin për të? Duket se qenia njerëzore është më e ndërlikuar se kaq, ose disa qenie (njerëz) mbesin në provim, një apo dy herë, dhe pas kësaj korri sukses!

Kam medituat rreth jetës së Halid Ibn Velidit, e kam parë se ky burrë ka qenë shkak në dështimin e muslimanëve në betejën e Uhudit dhe rënien dëshmorë të shtatëdhjetë trimave, prej më të mirëve të besimtarëve! E, megjithatë, pas kësaj iu hap zemra për Islamin dhe udhëhoqi ushtritë muslimane në betejë, që varrosën perandorin romake, e cila i rezistoi zhdukjes për shekuj me radhë!

Kështu është edhe Amr Ibn As, i cili hyri vonë në Islam, pak përpara se të çlirohej Meka, e megjithatë çliroi Egjiptin dhe gëzoi me Islam burra e breza të tërë!

Të fshehtat e qenieve (njerëzve) nuk i di askush, përveç Allahut. Ndoshta dikush ngushtohet për një çështje ndaj një çështjeje tjetër, pastaj ditët zbulojnë se në zemrën e tij ka thesare mirësie.

Kjo e vërtetë shfaqet në analizën e Kur'anit Famëllartë ndaj asaj që i goditi muslimanët në Uhud dhe dhimbjes së Pejgamberit (a.s) për shokët e tij të dëmtuar, e zemërimin e tij të madh ndaj idhujtarëve. Allahu i Madhëruar i thotë: “Ty nuk të përket aspak kjo çështje. Ua pranon pendimin, apo i dënon, ata janë zullumqarë. Allahut i përket çfarë është në qiej dhe çfarë është në tokë, falë kë të dojë dhe dënon kë të dojë.”¹

1. Kur'ani, Ali Imran: 128-129.

TË FSHEHTAT E NJERËZVE

“Ty nuk të përket aspak kjo çështje. Ua pranon pendimin, apo i dënon, ata janë zullumqarë. Allahut i përket çfarë është në qiej dhe çfarë është në tokë, falë kë të dojë dhe dënon kë të dojë” - Kur'ani, 3:128

Shenja e pendimit të disa njerëzve prej armiqve të Islamit, që i luftuan me ashpërsi, përsëritet edhe në betejën e Ahzabit, në fjalën e Allahut (xh.sh): “Prej besimtarëve ka burra që ishin të singertë në atë çfarë i premtoan Allahut, disa prej tyre vdiqën dhe disa të tjerë presin...”², pastaj Allahu i Madhëruar thotë: “Për t'i shpërblyer Allahu të singertët me singëritetin e tyre dhe t'i dënojë hipokritët nëse do, apo t'ia pranojë pendimin atyre.”³

Vërtet, pas kësaj hynë në Islam njerëz, me gjithë ngushtimin që kishin më parë për të.

Ndoshta disa njerëz vonojnë në përqafimin e të Vërtetës për shkak të ndonjë rëndomësie që i ka rrethuar, prandaj nuk lejohet të na shtyjë kjo gjë për tu bërë zullum, ndoshta Allahu bën prej tyre ndihmëtarë të fesë së Tij.

Kam vënë re se Allahu i Madhëruar ua ka zgjatur litarin disa lloje njerëzish prej jobesimtarëve, ndoshta ata ndalen.

Medito pak rreth fjalës së Allahut për hipokritët: “A nuk e shohin, se ata sprovohen në çdo vit një herë, apo dy herë, pastaj nuk pendohen dhe as nuk përkujtohen (marrin mësim)”⁴? Allahu nuk e diskrediton robin e Tij me të parën herë, por duron ndaj tij

2. Kur'ani, El-Ahzabë: 23.
3. Kur'ani, El-Ahzabë: 24.
4. Kur'ani, Et-Teube: 126.

dhe i lë afat, ndoshta ai turpërohet dhe pendohet. Nëse këmbëngulë në shtrembërimin e vet, atëherë “shërimi i fundit është djegia”, dhe e diskrediton, sepse ai nuk përfitoi prej perdes (mbulimit) që i bëri Allahu dhe durimit të Tij me të!

Allahu ka pranuar njerëz, që kanë përfutur prej perdes (mbulimit) dhe durimit të Tij, është përmirësuar besimi i tyre dhe gjendjen e kanë rregulluar, ashtu siç është zemëruar ndaj disa të tjerëve, kanë menduar se vonesa është heshtje, lënia afat është neglizhencë dhe kështu kanë vazhduar në rrugën e sherrit deri në fund. Për ta është edhe fjala e Allahut: “Bënë intriga të mëdha, por edhe Ne bëmë komplete ndaj tyre, e ata nuk e ndjenë. Shiko se, si ka qenë ndëshkimi i intrigës së tyre, ku Ne i shkatërruam ata dhe popullin e tyre, të gjithë.”⁵

Thirrësi duhet të kenë durim dhe kumtim të mirë, e të mos lejojnë që ndjenjat e zemërimit ta shtyjnë në fjalë të ashpra dhe mendim të keq. Dhe, le të marrim shembull nga i Dërguari ynë fisnik në kujdesin ndaj njerëzve, keqardhjen për shtrembërimin dhe shpresën në udhëzimin e tyre.

Përktheu nga arabishtja dhe përshtati në shqip:

Lavdrim Hamja

5. Kur'ani, En-Neml: 50-51.

A mjafton një eksperiencë e vetme për të zbuluar natyrën e njeriut dhe vendimin për të?

NE MUSLIMANËT, NUK KEMI PASUR NDONJËHERË KOMPLEKSE NGA DIVERSITETI FETAR!

Më kërkoi sot im bir, Hakimi disa sqarime rreth një mësimi në lëndën “Vendlindja ime - Shkodra”, për klasat e 5-ta. Libri në fjalë ka për autore dy zonja, që nuk e di specializimin e tyre dhe, natyrshëm nuk jam specialist i mirëfilltë i fushës për të cilën ato kanë shkruar. Por, gjatë shfletimit të librit konstatova disa dukuri, për të cilat duhet të ndalem e të kërkoj llogari me të madhe, për shumë arsye.

(Duke iu rikthyer arkivit të hytbeve të xhumasë ndër vite, më rezultoi se për këtë temë kam folur gjatë edhe para shumë vitesh. Asokohe, ka pasur disa reagime pozitive, ndonëse botimi i sotëm është i njëjti, ai i vitit 2008 dhe mësohet në krejt shkollat e qytetit tim).

Tano Banushi, Roza Anagnosti, Rikard Ljarja, Zef Çoba.

Personalitetet e përmendura kanë emrin dhe famën e tyre, secili në fushën e tij. Absolutisht, i respektoj dhe i vlerësoj për kontributet e tyre. (Nuk do merrem me asnjërin personalisht, se nuk më takon, edhe pse mund të kem rezervat e mia të argumentuara për ndonjërin prej tyre, sidomos nga ata që nuk jetojnë më, por nuk është ky objekti i këtyre shënimeve).

Ajo që dua të theksoj dhe të tërheq vëmendjen me të madhe është fakti se përse janë eliminuar krejtësisht personalitetet muslimane të Shkodrës, në fusha të ndryshme të jetës, intelektualë, dijetarë, pajtimtarë, shkrimtarë, drejtues të arsimit,


Kohëve të fundit

jemi dëshmitar të rritjes së frymës së islamofobisë dhe mlllefeve të pashembullta, që vijnë nga andej-kënde, kryesisht nga jomuslimanë. Sharje, fyerje, provokime, hile, dyfytirësi, tinzari etj!

madje tendencioz dhe krejtësisht i pasaktë!” Dhe, ambasadori kishte të drejtë, kjo është e vërteta e madhe, me të cilën është veshur Shkodra e 26 viteve të fundit, nën trysinë e politikave asimiluese të elementit islam, që përbën pjesën dominuese të Shkodrës. Është një realitet që dëshmohet edhe sot, sidomos në administratë, arsim, politikë, sport, kulturë e në çdo fushë!?

Ne muslimanët, nuk kemi pasur ndonjëherë komplekse nga diversiteti fetar dhe as që kemi, sepse vlerat e harmonisë ndërfaqetare i kemi ndërtuar me pastërti dhe singëritet, si një shtyllë e rëndësishme e komunikimit kur'anor dhe e traditave të Hz. Muhammedit (a.s) në marrëdhëniet sociale! Kështu do të jetë përherë, përtej shejtanëve dhe cytjeve të tyre, por, tendencat raciste dhe përçarëse, duhet t'i frenojmë dhe t'i refuzojmë, sepse nuk i bëjnë mirë qytetit dhe ekuilibrave të tij!

Kohëve të fundit jemi dëshmitar të rritjes së frymës së islamofobisë dhe mlllefeve të pashembullta, që vijnë nga andej-kënde, kryesisht nga jomuslimanë. Sharje, fyerje, provokime, hile, dyfytirësi, tinzari etj! E vëmë re edhe në laicizmin selektiv të politikës shqiptare. Kësaj të fundit i ka dalë boja prej kohësh në këtë drejtim!? Ndonjë derdimen ka shkruar deri aty, sa të na kërkojë llogari publikisht edhe për tekstet tona të shenjta liturgjike, edhe për zbukurimet e xhamive?! Madje e ka kaluar cakun e kufirit të logjikës, duke kërkuar ndërhyrjen e



Libri në fjalë është një tekst racist me tendencë antiislame të theksuar, dukuri që vihet re, sidomos në kapitullin e figurave të shquara të Shkodrës. Po i rreshtoj, sipas rendit që autorët kanë përzgjedhur: Marin Barleti, Marin Biçikemi, Oso Kuka, Vaso Pasha, Pjetër Marubi, Filip Shiroka, Kolë Idromeno, Palokë Kurti, Ndre Mjeda, Luigj Gurakuqi, Hilë Mosi, Millosh Gjergj Nikolla, Vojo Kushi, Jordan Misja, Vasil Shanto, Prenk Jakova, Branko Kadia, Marie Logoreci, Ndre Shkjezi, Loro Boriçi, Lec Bushati, Çesk Zadeja, Pjetër Gaci, Gjon Simoni, Tinka Kurti, Bep Shiroka, Serafin Fanko,

politikës, njerëz të kulturës e artit, sportit e çdo sferë tjetër të jetës?! Kjo është Shkodër e cungët, e mangët, sakate, jo Shkodra ime!

Kjo më kujton bashkëbisedimin me njërin prej ambasadorëve të nderuar, me të cilin po flisnim rreth Shkodrës dhe veçorive të saj. Më tha: “I nderuar Myfti, fillimisht, kur kam ardhur në vendin tuaj, më thanë se Shkodra është qyteti i zonjës filani, një qytet me pakicë muslimane. Mirëpo, nga vizita në qytetin tuaj, po konstatoj se ky prezantim që i bëhet qytetit tuaj në rangjet diplomatike nuk është i saktë,

institucioneve shtetërore për heqjen e tyre!? Dhe, ky është një kulm injorance, që ia japim fytyrës kujtdo që tejkalon kufijtë e njerëzores në marrëdhënie me fenë tonë dhe shenjtëritë e saj, kushdo e çfarëdo qoftë!

Ndonjë tjetër, që hiqet si atdhetar, na kërkon shqipërimin e tyre se nuk i kupton në arabisht (a turqisht, sa qesharake është kjo e fundit?!); kurrë mos i kuptoftë, nuk e ka për detyrë as për obligim, as fetar, as kombëtar, as moral e as social nga pozita e fesë që ka! Secili të shohë punën e tij dhe të respektojë kufijtë e tolerancës, si dhe të kontribuojë maksimalisht për harmoninë kombëtare, që e kemi të shenjtë! Keni dëgjuar ndonjëherë nga ndonjëri prej nesh të mungojë respekt ndaj teksteve latine, greke a hebraike të liturgjive joislame? Kurrë dhe kurrë nuk do të dëgjoni!

Teksti “Vendlindja ime - Shkodra” cek edhe xhaminë e Sulltan Mehmet Fatihut, që asnjëherë se përmend si të tillë!? Pavarësisht tendencave përçarëse fetare të mbështetura edhe nga Ministria e Kulturës ndër vite, si dhe nga ndonjë ambasadë e huaj në vendin tonë, historia mbetet histori; faltorja e kalasë Shkodër është xhami, jo katedrale a kishë, sikurse e prezanton



Arben Halluni, teolog

Hixhreti (Emigrimi) i Profetit Muhamed (a.s) në pamje të jashtme ishte shpërngulja nga një vend në një vend tjetër, respektivisht nga Mekka në Medine. Mirëpo, hixhreti në esencë ishte ndryshe. Hixhreti i të Dërguarit ishte largimi nga një vend i mbushur me politeizëm në një vend ku të ushtrohej me lehtësi nënshtrimi ndaj Zotit të vërtetë; largim nga arroganca për të mbërritur në qetësi shpirtërore,

NE MUSLIMANËT, NUK KEMI PASUR NDONJËHERË KOMPLEKSE
NGA DIVERSITETI FETAR DHE AS QË KEMI, SEPSE VLERAT
E HARMONISË NDËRFETARE I KEMI NDËRTUAR
ME PASTËRTI DHE SINQERITET,
SI NJË SHTYLLË E RËNDËSISHME E KOMUNIKIMIT KUR'ANOR
DHE E TRADITAVE TË HZ. MUHAMMEDIT (A.S)
NË MARRËDHËNIET SOCIALE! KËSHU DO TË JETË PËRHERË,
PËRTEJ SHEJTANËVE DHE CYTJEVE TË TYRE,
POR, TENDENCAT RACISTE DHE PËRÇARËSE,
DUHET T'I FRENOJMË DHE T'I REFUZOJMË,
SEPSE NUK I BËJNË MIRË QYTETIT DHE EKUILIBRAVE TË TIJ!

libri në fjalë dhe sikur e gjejmë edhe në emërtimet zyrtare në google me një tendencë të dukshme përjashtuese të elementit dhe identitetit islam të saj!

Këto janë tema delikate, për të cilat nuk duhet të ketë asnjë tolerancë ndaj kujtdo dhe nuk duhet lejuar që këto tekste të përhapen në mesin e fëmijëve tanë. Jo në këtë mënyrë, jo në këtë rrobë!

Frymën e harmonisë ndërjetare e kemi ushqyer me shpirtin tonë prej shekujsh, do të vazhdojmë ta bëjmë duke respektuar fenë e secilit, kulturën e tij, lirinë dhe përzgjedhjen e lirë. Do të vazhdojmë të punojmë, që harmonia të mbetet vlerë mbi vlerat,

por në të njëjtën kohë, do të tërheqim vëmendjen ndaj çdo tendence, me a pa qëllim, që tenton të prishë këtë ekuilibër të shenjtë, për të cilin do të japim llogari para Zotit, fillimisht, por edhe para brezave që vijnë!

Për fund, mendoj se Komuniteti Mysliman i Shqipërisë duhet të ndërhyjë me forcë pranë Ministrisë së Arsimit, për korrigjimin dhe plotësimin e këtyre teksteve të cungëta, tendencioze, raciste dhe abuzive me elementin musliman.

Imam Muhamed B. Sytari

Myfti i Zonës Shkodër

Shkodër, më 22 shtator 2016

HIXHRETI – FILLIMI JONË!

largim nga një vend i mbushur me padrejtësi dhe të ndaluara në një vend ku ushtrohen të drejtat dhe të lejuarat e Allahut (xh.sh). Hixhreti nga një vend në një vend tjetër nuk ka rol në kohën e sotme. Për këtë Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Nuk ka hixhret mbas çlirimit (të Mekkes)”. Ndërsa hixhreti tek Allahu (xh.sh) është i qëndrueshëm dhe i vazhdueshëm deri në ditën e Kijametit...

Pa mëdyshje ngjarja e hixhretit shënon fillimin tonë, fillimin e historisë islame, fillimin e kalendarit Islam jo vetëm në kuptimin kronologjik të muajve por edhe në kuptimin që në çdo vit ymeti islam ka mundësi të bëjë evidencën dhe inventarin e veprave të përgjithshme të çdo viti që lëmë pas dhe zotohet për një vit të mbarë në të gjitha drejtimet si shpirtërore, morale, materiale etj...

A ka gjë më të mrekullueshme që ymeti islam në fund të vitit t'i kërkojë

llogari vetes së vet, të shohë: çfarë ka bërë në të djeshmen e tij? çfarë bën në sotmen e tij? dhe çfarë do të bëjë në të nesërmen e tij? Të gjitha këto janë çështje të popujve myslimanë që duhet të jenë të gjalla shpirtërisht dhe fizikisht. Ndërsa, nga popujt e vdekur nuk pritet as shpresë dhe as mirësi prej tyre. Ata në një gjendje të tillë nuk mendojnë për të djeshmen çfarë kanë punuar as për të sotmen çfarë bëjnë dhe as për të nesërmen çfarë do të bëjnë.

Ne besojmë se ymeti Muhamedije nuk do të vdesë, sepse është ymeti i përhershëm deri në ditën e Kijametit. Është vula e mbarë ymeteve të mëparshme; është ymeti të cilin Allahu (xh.sh) e ka ngarkuar me revelatë përfundimtare dhe të përhershme deri në Ditën e Gjykimit që s'ka dyshim se ka me ndodhë.

Ymeti Muhammedije do të qëndrojë, dhe do të qëndrojë si bashkësi e madhe

njerëzish të kapur gjithmonë pa luhatje mbas të drejtës, mbas lidhjes Islame, pas paqes dhe harmonisë që përcjell në çdo kohë dhe në çdo vend. Allahu (xh.sh), thotë në Kur'an: “E ndër ata që krijuam Ne, ka njerëz (ymet) që udhëzojnë në të drejtën e edhe veprojnë me të”. (El-Ara'fë:181)

Për rëndësinë që i ka dhënë Krijuesi i gjithësisë duhet që ne të punojmë fort për shumimin e kësaj bashkësie, për forcimin dhe zhvillimin e saj deri në kryerjen e misionit të ngarkuar. Sado që ky ymet të përballët me stuhitë e forta që vijnë andej e këtej për të tundur pemën e devotshmërisë, sado që retë e zeza të zënë qiellin e kaltër të pastërtisë shpirtërore, do vijë një ditë që stuhitë do të kalojnë të dështuara pa dëmtuar rrënjët e besimit dhe retë do të hapen për të sjellë diellin e shndritshëm të Islamit. Dhe jo vetëm kaq, por, pas natës do vijë agimi dhe pas vështirësisë vjen lehtësimi. “E, pa dyshim se pas vështirësisë është lehtësimi. Vërtet, pas vështirësisë vjen lehtësimi”. - (Kur'an, 94: 5-6)

Shpresa është e fortë që t'i kthejë këtij ymeti besimin tek Allahu (xh.sh), bashkimin dhe vlerat më të mirë që mund të ketë kjo botë. Ky është një mësim mjaft i rëndësishëm që ne e mësojmë pikërisht nga hixhreti i Pejgamberit (a.s). Ai kur doli nga vendi i tij i lindjes për të emigruar së bashku me shokun e tij të ngushtë, Ebu Bekrin, vendosi ta ndjekë një nga kalorësit arabë, Suraka Bin Malik, i lakmuar që të merrte të njëqind devet, shpërblim që kishte ofruar paria kurejshite për atë që sjell Muhamedin (a.s) së bashku me shokun e tij të gjallë ose të vdekur. Suraka vetë u drejtua për në shtëpi, mbasi u armatosi i hipi kalit dhe më të shpejtë u nis për në drejtimin që kishte marrë informacion. Dy herë u pengua kali udhës nga shpejtësia dhe e rrëzoi përdhe. Kur e pa Profetin (a.s), ngau ca më tepër kalin dhe ky, si t'i kishte shkarë këmba, e përplasi përdhe disa metra tej. Surakasë i hyri frika dhe iu mbush mendja se ajo që ndodhi ishte vepra e Allahut (xh.sh), i Cili e kishte dërguar Muhamedin (a.s), si Profet të fundit për mbarë njerëzimin. Tregohet se Surakaja ka thënë: “Këtu besova se kjo ishte shenja që Muhamedi do të fitonte”. Suraka e thirri Muhamedin (a.s), i tha se kishte hequr dorë nga vrasja e tij dhe i kërkoi ndjesë. Muhamedi (a.s) e fali dhe e paralajmëroi se një ditë do të vishte stilitë e perandorit të Persisë.

Ky paralajmërim u vërtetua 23 vjet më vonë. Në kohën e sunduesit të dytë të myslimanëve, Omerit (r.a), myslimanët çliruan nga shirku(politeizmi) Persinë. Hz. Omeri dërgoi e thirri Surakanë dhe i dhuroi stilitë e perandorit të Persisë sikundër që i kishte premtuar Profeti i Islamit (a.s).

Kështu ka qenë shpresa e të Dërguarit të Allahut (xh.sh). Edhe pse ai doli i imponuar nga vendi, ai besonte se përkrahja e Krijuesit të gjithësisë do t'i jepte fitoren, feja e tij do të përhapej dhe Allahu (xh.sh) do t'ju jepte ithtarëve të tij besimtarë ngadhënjimin islam.

Dhe kështu në të vërtetë ndodhi. Profeti (a.s) triumfoi dhe u kthye fitimtar në Meken e nderuar duke i thyer vetë me dorën e tij statujat dhe idhujt që kishin mbushur Qaben e shenjtë dhe Meken përreth. Gjatë rrënimit të tyre shprehte këto fjalë të Allahut (xh.sh): “Dhe thuaj: Erdhi e vërteta e u zhduk e kota. Vërtet, e kota gjithnjë ka qenë e zhdukur”. - (Israë: 81)

Kjo është natyra e së vërtetës, e cila domosdo do të ngadhënjë dhe ngadhënjimi vjen atëherë kur bëhen përpjekje të urta dhe mbështetje të përbashkëta me burra që besojnë tek Allahu (xh.sh) dhe që bëjnë thirrje në Islam, në mënyrën më të mirë dhe më paqësore.

Pra e vërteta nuk fitohet vetëm, por fitohet me burra të vërtetë Islamë që e shenjtërojnë misionin islam. Allahu i thotë të Dërguarit të tij që është shembull për të gjithë njerëzimin: “Po nëse duan të mashtrojnë me të (me paqen), ty të mjafton Allahu. Ai është që të fuqizojë ty me ndihmën e vet dhe me besimtarët”. - (El-Enfalë: 62)

Muslimani shpreson se e vërteta do të ngadhënjë vetëm nga fuqia e Allahut (xh.sh) dhe nga jo nga fuqia e dhunshme e njeriut. “Dhe Ai është që bashkoi zemrat e tyre, Edhe sikur ta shpenzosh gjithë atë që është në tokë, nuk do të mund t'i bashkoje zemrat e tyre, por Allahu bëri bashkimin e tyre, pse Ai është i gjithëfuqishëm, i urtë”. - (El-Enfalë:63)

Le të jemi ne myslimanët e sotëm dhe në të gjitha kohërat dhe vendet ithtarë të së vërtetës, shërbëtorë dhe ndihmës të saj. Le të pajisemi sot e gjithmonë me shpirtin e historisë së Bedrit dhe le të mbajmë gjallë shpirtin e muhaxhirinëve (emigrantëve në kohën e Pejgamberit (a.s) që emigruan bashkë me të nga Mekka në

A ka gjë më

të mrekullueshme që ymeti

islam në fund të vitit t'i

kërkojë llogari vetes së vet,

të shohë: çfarë ka bërë në

të djeshmen e tij?

çfarë bën në sotmen e tij?

dhe çfarë do të bëjë

në të nesërmen e tij?

Medine) dhe të ensarëve (përkrahësit e muhaxhirinëve). Ja se ç'ka thotë Allahu (xh.sh) në Kur'an për muhaxhirinët: “Ajo (pronë) u takon muhaxhirinëve të varfër, të cilët u dëbuan prej shtëpive të tyre dhe prej pasurisë së tyre, duke kërkuar mirësinë dhe kënaqësinë prej Allahut, dhe që ndihmojnë Allahun dhe të dërguarin e Tij, të tillët janë të sinqertët”. - (El-Hashër: 8) Ndërsa për ensarët thotë: “Edhe ata që përgatitën vendin(Medinën) dhe besimin para tyre, i duan ata që shpërnguleshin tek ata dhe nuk ndiejnë në gjokset e tyre ndonjë nevojë (për zili a tjetër) nga ajo që u jepej atyre (muhaxhirëve), madje edhe sikur kishin nevojë për të, ata u jepnin përparësi atyre para vetvetes. Kush është i ruajtur prej lakmisë së vet, të tillët janë të shpëtuar”. - (El-Hashër:9)

Hixhreti gjithashtu na mëson se ne pa Islamin nuk mund të jemi asgjë, sepse Islami është çdo gjë dhe përfshin çdo sferë të kësaj jete lëndore, pra Islami është sistem jete, është se si njerëzit mund të jetojnë në drejtësi, zhvillim dhe paqe.

Jo vetëm kaq por Allahu (xh.sh) nuk do të na japë krenarinë vetëm me anë të besimit që kemi zgjedhur me dëshirë dhe me gjithë shpirt, sikundër ka thënë Omer Bin El-Hatab (r.a): “Ishin populli më i ulët dhe Allahu na nderoi me Islamin. Nëse e kërkojmë krenarinë diku tjetër, atëherë vetëm nënçmimin e Zotit fuqplotë do të kemi”.

Allahut (xh.sh) t'i lutemi, që të sotmen ta bëjë më të mirë se të djeshmen dhe të nesërmen me të mirë se sa të sotmen. Amin!

O ALLAH, TË FALËNDEROJ TY QË MA MUNDËSOVE TË JEM MIK NË SHTËPINË TËNDE

(Intervistë me teologun Ervil Kuçi, që sapo është kthyer nga Haxhi 1437/2016)

1- I nderuar Haxhi, këtë vit, ju së bashku me një grup të madh besimtarësh nga Shkodra, kryet ritualet e Haxhit. Si mund ta përshkruani këtë eksperiencë besimi në vendet e shenjtë?

Si fillim, falënderimet i takojnë Allahut, i Cili ma mundësoi këtë eksperiencë besimi duke më zgjedhur mua midis shumë besimtarëve të tjerë të Shkodrës që të jem pjesëtar i grupit të haxhilerëve të këtij viti. Është një eksperiencë e veçantë, aq sa vështirë të gresh fjalët e duhura për ta përshkruar. Edhe pse para 3 viteve unë e kreu haxhin tim të parë, sot kam arritur në një konkluzion, që çdo Haxh ka veçantinë e vet dhe nuk ngjan me të parin, edhe pse rituali mbetet i njëjti. Ajo që përjetova në këtë Haxh ishte ndjesia e të privilegjuarit, çdo ditë që ndodhesha atje. Sigurisht kjo ndjesi nuk ka të bëjë me kushtet e qëndrimit atje, apo me mënyrën e trajtimit tonë atje. Kjo ndjesi më vinte në mënyrë spontane, sepse vazhdimisht e kisha në mendjen time, sa herë rrija e shikoja me vëmendje haxhilerë nga kombësi dhe popuj të ndryshëm, që nuk i kisha parë ndonjëherë në jetën time dhe as kam menduar se do t'i shoh ndonjëherë. Thoja me vete: I shikon gjithë këta njerëz? Të gjithë kanë ardhur me të njëjtin qëllim sikurse ti, secili nga këta njerëz me kombësi dhe kultura të ndryshme janë të ftuarit e Allahut, nga miliona myslimanë anembanë botës. Allahu me urtësinë e Tij ka zgjedhur këta, sikurse të ka zgjedhur ty, që të jenë mik në Shtëpinë e Tij, që të të mundësojë të jesh mirënjohës për mirësitë dhe begatitë që të ka dhënë, po në shtëpinë e Tij, që të falesh dhe të lutesh të bësh tavaf të të shpërblejë me pafundësi sevapësh dhe mirësishë. Ndoshta të tjerët kanë përjetuar ndryshe nga unë, ama mua personalisht kjo ndjesi më ka ndjekur gjatë gjithë qëndrimit tim në Haxh.

2- Transmetohet se: “Ai që e bën Haxhin, pa shkelje e pa gjynahe, do të kthehet si ditën që e ka lindur nëna e tij”. Si reflektohet ky hadith në marrëdhëniet e haxhilerëve me njëri-tjetrin?



Të vërtetën ka thënë Pejgamberi (a.s)! Ajo që të bën përshtypje më së shumti atje është mënyra e sjelljes së haxhilerëve me njëri-tjetrin. Me këtë nënkuptoj, jo vetëm haxhilerët shqiptarë apo shkodranë, por të gjithë haxhilerët që ishin atje. Haxhi ka një veti, që nxjerr në pah virtytet më të mira, altruizmin edhe të atyre që ndoshta nuk janë praktikantë të rregullt të namazit e adhurimeve të tjera. Secili, para se të ndërmarë këtë udhëtim të jetës, (siç quhet edhe ndryshe), përveçse ka qëllim që të kryejë një prej shtyllave të Islamit, qëllimi i tij është edhe t'i bindet Allahut më së miri, aq më tepër në këtë aspekt ku Ai ka urdhëruar në Kur'anin Famëlartë: “Ai që ia obligon vetes së tij Haxhin, (ta dijë se) nuk ka martesë, sharje, fyerje as debate në Haxh.”¹

Duke u nisur nga kjo për çdo haxhi, çdo vepër, ose çdo thënie e tij është e matur, sepse secili ka për qëllim të fitojë kënaqësinë e Allahut dhe si pasojë e kësaj discipline të besimit, dashje pa dashje njeriu nxjerr në pah anën e tij më të mirë, frytet e besimit të tij, moralin e lartë, altruizmin. Kujdesi për vëllanë që ke në këtë udhëtim të jetës,

1. Kur'ani, El-Bekare: 197.

respekti dhe dëshira për t'u socializuar sa më tepër me këdo që takon, ngaqë çdo njeri prej tyre ka të njëjtin qëllim sikurse ti, dhe padyshim reflektimi i atij ajeti dhe i atij hadithi të Pejgamberit (a.s) vihet re midis haxhilerëve në ato aspekte që përmenda më lart.

3. Çfarë ndjen një besimtar musliman, kur takohet për herë të parë me Qaben e Madhnueshme?

Ehh... mendoj se përgjigjja ime ndaj kësaj pyetje nuk mund të përfaqësojë çdo besimtar, sepse secili kur e shih Qaben për herë të parë e përjeton ndryshe nga të tjerët. Unë flas për përvojën time, kur e vështrova për herë të parë, emocione pa fund, heshtje, soditje pa ngopje... ishte aty..., po, po, pikërisht ajo Shtëpia me mbulesë të zezë që isha mësuar ta shoh nëpërmjet fotove të internetit, ose kartolinave e posterave, që kemi pasur nëpër xhamia apo në shtëpitë tona. Ndërsa, kur je përpara saj, e shikon me sy dhe ke dëshirë ta prekësh, ndoshta edhe të vë ballin tim tek muret e saj, ndoshta edhe të rri me orë e orë po të më jepej mundësia. Se di, në atë moment mbasi përjetoja këto emocione më vinte në mendje, veç një fjalë që e përsërisja çdo sekondë: “O Allah, të falënderoj Ty që ma mundësove të jem mik në



shtëpinë Tënde...” Kjo ishte pak a shumë ndjesia ime ...

4. Pjesë e udhëtimit të haxhit është edhe vizita e qytetit të Medines, ku prehet Resulull-llahu (a.s). Si ndjehet njeriu në Medine?

Vizita e xhamisë së Pejgamberit (a.s), zakonisht bëhet mbasi kryen komplet rituali i Haxhit. Unë e quaj këtë vizitë, si “Qershia mbi tortë”, për vetë faktin se vizita e Medines së Pejgamberit (a.s) është e gjitha për t'u shijuar, përfshi këtu qëndrimin atje, namazet në xhaminë e Profetit (a.s), namazi në Raudan Sherife², dhënia e selamit Resulullahut (a.s) dhe shokëve të tij të nderuar, njëkohësisht edhe dy kalifëve të mëdhenj të Islamit, Ebu Bekrit dhe Omerit (r.a). Ndjesia e qëndrimit në Medine është e gjitha prehje, qetësi shpirtërore, nostalgji për çdo gjë që ke lexuar nga jeta e Pejgamberit (a.s) dhe shokëve të tij. Të duket sikur çdo moment që ke lexuar, ose mësuar po e përjeton.... po ec mbi gjurmët e tyre, po falesh ku është falur i Dërguari i Allahut, po lutesh dhe po bie salavatë mbi Pejgamberin (a.s). Po në shtëpinë e tij, po ec në ato vende ku janë zhvilluar betejat e para të Islamit dhe kanë rënë dëshmorët e parë të tij, në mënyrë që ky mesazh hyjnor të mbërrinte edhe te ne, në Shkodrën tonë të shtrenjtë. Si ndjehet njeriu atje? Ndjehesh si vëlla i Pejgamberit (a.s), ashtu siç i ka quajtur ai brezat që do të vijin pas tij: “Vëllezërit e mi janë ata të cilët më kanë besuar mua dhe atë me të cilën jam dërguar, por nuk më kanë parë”. Besoj se ky hadith e shpjegon

2. Quhet vendi mes minberit të Pejgamberit (a.s) dhe varrit të tij.

më së miri ndjesinë e të qëndruarit në Medine.

5. A do kishit shkuar sërish në Haxh, duke marrë parasysh atë që thuhet se: “Haxhi është gjysma e xhihadit”, pra një adhuring i rrethuar me vështirësi e lodhje?

Në ditën e Arafatit, ku ishim miliona haxhilerë nga anembanë bota, tek Mali i Mëshirës, mbasi kishte kaluar një pjesë e ditës e mbushur me adhuring, ndihesha shumë i emocionuar, edhe pse si natyrë jam ndryshe. Por, aty tek Mali i Mëshirës, mali i Arafatit, në mendjen time më silleshin vetëm këto fjalë: “Ia vlejti gjithçka... ia vlejti çdo gjë..! Çdo dërsitje a lodhje, orë e orë pagjumësi dhe ecje pafund, çdo adhuring e çdo gjë që përjetova këto ditë... Faleminderit, Zoti im!” A do ta kisha bërë përsëri? E them me plot gojën dhe me bindje në zemër: Po, prapë dhe prapë, sa herë të më ftojë Allahu, do të jem aty, në dashtë Allahu!

6. Në fund të kësaj interviste cili është mesazhi juaj për haxhilerët e ardhshëm të Shkodrës?

Mesazhi im për çdo haxhi të ardhshëm ose çdo besimtar, nëse Allahu ju ka begatuar me mundësinë financiare që të shkoni në Haxh, mos e neglizhoni, mos e shtyni, por me emër të Allahut aplikoni dhe kryejeni, dhe provoni ndjesinë e të qënurit mik në shtëpinë e Tij. Mbasi ta kryeni haxhin do ta kuptoni se është një nga mirësitë më të mëdha që Allahu ju ka dhënë në këtë botë. Lutem për çdo besimtar që Allahu t'ia mundësojë këtë privilegj, Allahumme Amin!



“Pejgamberi (a.s) ka thënë:

“Prej ditëve tuaja,

dita më e mirë

është dita e xhuma,

prandaj bini


sa më shumë salavatë

mbi mua,

sepse salavati juaj

ekspozohet tek unë.”

(Transmetuar nga Ebu David)



Sheikh Vehbi S. Gavoçi

Kemi përmendur mbledhjen e Kur'anit në kohë të kalifit Ebu Bekër, gjë që e pëlqen të gjithë sahabët, se lidhej me ruajtjen e Kur'anit, që e ka përmendur Zoti (xh.sh) në Kur'an.

1. Transmeton Ebu Davudi e disa të tjerë se kur ndërroi jetë Profeti (a.s) erdhi Ebu Bekri dhe vuri buzën e vet mbi ballin e Profetit (a.s) dhe e puthte duke thënë: “T’u bëfsha fli unë me nënë e baba, ishe i mirë i gjallë e tashti edhe i vdekur”. Dikush ndoshta kujton se kjo është mënyrë, sexhde që nuk i bëhet kujt përveç Zotit (xh.sh). Jo, jo, kjo gjë s’ka të bëjnë me të, se puthja e dorës dhe e ballit të Profetit (a.s), ulemave (dijetarëve), prindërve është gjë e pëlqyer, mbasi ka ndodhur në kohë të Profetit (a.s), ku erdhën aty dy çifutë dhe e panë se është me të vërtetë Profeti (a.s), atëherë i puthën duart e këmbët, siç ka ardhur në librin e Tirmidhiut, e siç erdhi Abdullahi me shokë te Profeti (a.s) ku i puthën dorën, siç ka ardhur në librin e Ebu Davudit, dhe si puthi djali i Thabitit dorën e hoxhës së tij Ibni Abbasit e të tjerë shembuj.

2. Transmeton Buhariu dhe të tjerë se kur ndërroi jetë Profeti (a.s) dolën nga Islami disa nga Riadi e Jemeni dhe disa të tjerë refuzuan me dhanë zekatin. Mblodhi kalifi Ebu Beker sahabët, e ata u ndanë në dy grupe: Njëri grup thoshte me i marrë me të butë e me i duru se ndoshta kthehen. Në këtë grup ishte edhe Hz. Omeri. Grupi tjetër thoshte me i luftu ata që kanë lënë fenë dhe ata që kanë ndalë zekatin, se zekati është e drejta e pasurisë që duhet me iu dhanë të vobektëve, e në këtë grup ishte Ebu Bekri. Me të mirën e Zotit (xh.sh) ajo ushtri që shkoi në Riad e në Jemen u kthye fitimtare mbas një kohe të shkurtër e kështu u ruajt feja e mori edhe më tepër hov e zhvillim përpara.

Kjo shpikje ka të bëjë me marrjen e zekatit, e cila është e drejta e të vobektëve në pasuri të pasanikut, kur të ndalohet si zullum që është, qeveria

DISA BIDATE TË PËLQYERA NË KOHË TË SAHABËVE

është e detyruar me ia dhënë të drejtën të zotit të së drejtës.

3. Na transmeton imam Shafiu ku thotë: I pari që i ka vënë myezinëve rrogë qe prijësi i udhëzuar Hz. Osmani. Kjo sjellje e tij nuk është refuzim i hadithit të Profetit (a.s) kur i thotë një sahabiut: “Të kesh me vete një myezin që nuk merr rrogë”, se hadithi tregon më të mirën dhe nuk ndalon me marrë rrogë. Me të vërtetë erdhi koha që u largua njerëzia nga shërbimi falas, qoftë myezin, imam, mësues Kur’ani, etj.

Me të vërtetë ky veprim i Hz. Osmanit solli një gjë të mirë që ndihmoi të kryhen nevojat fetare të domosdoshme.

4. Transmeton Bezzari nga një shok të Hz. Aliut (r.a) ku thotë: Dolëm me prijësin e besimtarëve Hz. Alinë për me falë Bajramin, këtu njeri prej shokëve të tij e pyeti për faljen nafle para faljes së Bajramit dhe Hz. Aliu nuk iu përgjigj. Më vonë erdhën edhe disa të tjerë ku e pyetën për këtë gjë, por përsëri ai nuk iu përgjigj. Kur erdhi koha e faljes dhe u fal, ra tekbir, bëri një ligjëratë, u ul, mandej hipi për me u kthy.

Këtu, disa thanë: Ej, prijësi i besimtarëve, shiko këta njerëz që falin mbas Bajramit nafle! Tha: “Çfarë kam për të bërë? Më pyetën për synetin e Profetit (a.s). Ai nuk është falë përpara Bajramit as mbas tij, kush të dojë bën si do vetë, ju mos po kujtoni se unë i ndaloj njerëzit me u falë”?

Transmeton Tirmidhiu nga disa sahabë, se ata e kanë të palejueshme me u falë përpara Bajramit dhe pas tij, si p.sh. Abdullahi, djali i Mes’udit, Enesi, etj. Disa të tjerë e kanë të ndaluar me u falë përpara Bajramit dhe mbas tij, si p.sh. Ebu Berzeh, etj. Kanë thënë disa dijetarë se prijësi nuk falet përpara Bajramit dhe mbas tij, kurse lejohen të tjerët. Kështu është përmendur nga imam Shafiu (r.a).

5. Transmeton Abdurrezaku nga Ubej, djali i Ka’bit (r.a) se Hz. Aliu kur u bë kalif, e urdhëroi këtë me e falë teravinë si imam i burrave, dhe e urdhëroi Arfexhenë me u falë si imame e grave.

A e shikojmë se sa mirë Hz. Alia (r.a) nuk ndaloj kënd për me u falë, pra kush kundërshton gjënë e mirë, sjelljen e mirë apo faljen, që nuk bie në kundërshtim me fenë, ai lloj njeriu quhet ndalues i të mirës, e besimtari nuk duhet të jetë i tillë.

Pra, jo vetëm Hz. Omeri ka bashkuar

popullin me e falë teravinë së bashku, ashtu edhe gratë, por edhe Hz. Alija, pra, disa SHIA që flasin keq për Hz. Omerin se ai ka bërë shpikje jo të pëlqyera kur ka mbledhur njerëzit për të falur teravinë bashkë. Ata gabojnë në dy pika, tregojnë edukatë të shtrembër me atë sahabi aq të madh (r.a) e lënë synetin e tij e të njerëzve në kohë të tij, bile edhe synetin e Hz. Alisë, që shiten se e duan shumë e se e nderojnë atë, e disa prej tyre gabojnë në dashurinë e tyre pa fakte, kur e preferojnë Hz. Alinë më shumë nga sahabët e parë, Ebu Bekrin, Omerin e Osmanin (r.a).

KËTO SHPIKJE NUK JANË HUMBJE

1. Shumë të rinj që kanë studiuar në vendet arabe, ose disa që janë dërguar nga vendet arabe të ndihmojnë këtu për besim, nga padija kanë sjellë shumë ngatërresa, për shembull: Thonë se nuk bën të përdorim tespitë në asnjë mënyrë, kur iu thuhet pse? Të përgjigjen me mburrje e me zë të fortë: Nuk i ka përdorur Profeti (a.s). Ne përmendëm shumë shembuj që çdo gjë e shpikur mbas Profetit (a.s) nuk është e ndaluar, në qoftë se ajo pajtohet me kërkesat e fesë, është e pëlqyer, e në qoftë se ajo nuk pajtohet me kërkesat, është e ndaluar.

Ne po shikojmë këtu që jemi të urdhëruar me përmendë shumë Zotin (xh.sh) siç ka ardhur në Kur’an, e jemi të urdhëruar me e përmendë Zotin (xh.sh) derisa të na thahet goja, siç ka ardhur në hadith.

Ai që do me ra Salavatë 100 herë ose më tepër, ndoshta gabon kur ai i numëron me gishta, kur lexon Kul huvall-lahu ehad, kur thotë La il-lahe il-lall-llah 100 herë ndoshta gabon numrin dhe ne themi se numri, që jemi urdhëruar me përmendë Zotin (xh.sh), me të ka sekretin e vet, pra nuk duhet ta teprojmë, ose ta mungojmë si dhikri Subhanell-llah 33 herë në fund të faljes.

Kjo gjë duket e qartë, megjithatë sqarohet me disa shembuj:

a) Transmeton Tirmidhiu e të tjerë nga Safia, gruaja e Profetit (a.s): Se hyri Profeti (a.s) ku isha dhe pau se kisha përpara vetes 4000 guralecë dhe me ato po përmendi Zotin (xh.sh). Më pyeti: A e ke përmendur Zotin (xh.sh) me të gjithë ato guralecë? A të mësoj disa fjalë më të mira se ato që ke përmendur? Ajo tha: I thashë: Më mëso. Më tha: Thuaj “Subhanell-llahi sa janë krijesat e Tij

(d.m.th numri i tyre) kjo gjë peshon sa peshon Arshi i Tij, dhe pesha e fjalëve të Tij”.

b) Transmeton Ahmedi se Ebu Safija, sahabi, e përmendte Zotin (xh. sh.) duke numëruar me guralecë.

c) Transmeton Ahmedi, djali i Hanbelit se sahabiu Ebu Hurejra ka pasur një pe të gjatë me 12 mijë neje (nyja), nuk flinte pa e përmendur Zotin (xh.sh) aq herë sa nyja kishte gjatësia e perit. Por më mirë është me ba ato tespih që i bëjnë pas faljes, është më mirë me i bërë me gishta se ato do të dëshmojnë, mirëpo edhe ai që bën ato tespih me tespih nuk duhet t’ia prishim qejfin pasi hidhërimi i myslimanit nuk është gjë e pëlqyeshme. Vetë Ibnu Tejmije ka pëlqyer me përdorë tespitë për përmendjen e Zotit (xh.sh) e jo për lojë.

2. Disa mërkiten kur shohin zakonin tuaj për me i këndue Telkinen të vdekurit, ose me lexue Kur’an te vorret, mërkiten e shpejtojnë kur thonë se është gjoja Bidat, humbje (dalalet).

Ata gabojnë se janë marrë me fjalë të disave që flasin pa dije e akuzojnë pa fakte. Thotë Ebu Hanife (r.a): “Ai që flet për një gjë pa dije, mos të kujtojnë se nuk pyetet nesër për çfarë ka fol”.

Thotë Profeti (a.s): “Ma guximtari për fetva (që flet në emër të fesë) është më guximtari për zjarr”. Prandaj dijetarët kanë qenë mësuar dhe kanë mësuar studentët e tyre me thënë: “Nuk e di kur nuk e dinë, bile edhe me ia përcjellë pyetjen e tij të tjerëve dhe në qoftë se e dinë përgjigjen e saj.

Thotë Profeti (a.s): “Përmendni përpara të vdekurit: “La-il-lahe il-lall-llah”. (Transmetuar nga Ebu Davudi).

Dijetarët janë ndarë në dy grupe, disa kanë thënë që hadithi tregon me i këndu atij që ka vdekur “la il-lahe il’lall-llah”, d.m.th me ia këndue Telkinen siç është në Medh-hebin tonë, të Shafiut e të Hanbelisë, është mirë me ia këndu telkinen atij që vdes siç ka ardhur në hadithin që e ka interpretuar Ibni Shahini, e ka thënë për atë Ibnu Haxheri, është hadith i mirë. Disa të tjerë kanë thënë që hadithi tregon se duhet me përmendë përpara atij që po vdes ato fjalë se ndoshta e mbaron jetën e tij me ato fjalë, e është për Xhennet.

Thotë imam Shafiu (r.a): “Është gjë e pëlqyeshme me i këndu të vdekurit diçka prej Kur’anit dhe në qoftë se e këndojmë krejt Kur’anin është më mirë”.

Thotë imam Shaabi: “Kur iu vdiste Ensarëve, vendlive të Medines ndonjë njeri, shkonin tek varri dhe i këndonin Kur’an”.

Ka ardhur një Hadith i Ibni Hibbanit

(e të tjerë) e është hadith i saktë, se Profeti (a.s) ka thënë: “Këndonia Jasinën të vdekurit”. Le të lexojmë këtë fjalë e le të punojmë me të në rastet e saj.

Transmeton Hal’lali në librin e tij (Me këndu te varret), se babai i Lexhlaxhit, Hanbeli, i tha djalit të vet: Kur të vdes më vini në tabut (dërrasë në të cilën vihet i vdekuri dhe bartet me të deri sa të futet në varr) dhe thuaj: Në emër të Zotit (xh. sh) dhe në fenë e Profetit (a.s), mandej më mbulon me dhe pak e nga pak, dhe këndo tek koka ime Fatihanë dhe fillimin e Sures Bekare, se kam dëgjuar Abdullahin, djalin e Hanbelit dhe i thashë: A bën gjë për me këndu Kur’an tek varret? Tha: Jo. Pyeta Jahjanë, djalin e Mainit, ai më përmendi këtë hadith. Thotë Aliu, djali i Musa Haddadit (thotë Ver’raku), ky hadith ka qenë i saktë.

Isha një ditë me Ahmedin, djalin e Hanbelit dhe Muhamedin, djalin e Kudamel Xhauherit në një xhenaze, ku u varros i vdekuri, i erdhi një qorr me lexu Kur’anin tek varri. Këtu Ahmedi i tha të verbrit: O njeri, leximi i Kur’anit te varri është Bidat, humbje. Kur u larguam nga varreza, Muhamedi, djali i Kudames tha: I thashë Ahmedit: O baba i Abdullahit, çfarë thua për Mubeshir Halebiun? Tha: Është i fortë në hadith. I thashë: A ke shkruar gjë hadithe nga ai? Pohoi. Muhamedi tha: Më ka treguar Mubeshiri nga Abdurrahmani, djali i Lexhlalit, nga babai i tij se ai kishte kërkuar të lërë testament se kur të varrosset, te koka e tij me i lexu fillimin e Sures Bekare dhe fundin e saj. I tha: Kam dëgjuar Abdullahin, djalin e Umerit, që ka kërkuar e ka lënë testament për një gjë të tillë. Këtu Ahmedi, djali i Hanbelit i tha Muhamedit: kthehu tek ai verbri e thuaj që të këndoje Kur’an tek varri.

Shikoje këtë fjalë qartë në librin “Shpirti” të Ibni Kaj-jim, hanbeli në medhheb, studenti i parë i Ibni Tejmijes, i cili përmendi disa tregime për t’u kënduar Kur’an të vdekurve dhe me iu dhanë atyre sevapin e këndimit të Kur’anit, siç është edhe në Medh-hebin tonë, të Malikut, Shafiut e Hanbeliut.

Hoxhallarët këtu bëjnë atë që kanë bërë kolegët e tyre në vendet e tjera. Kur përfundohet leximi i Kur’anit, mblidhen besimtarët dhe sevapi i asaj hatme i transmetohet atij Zotërie (a.s), mandej vëllezërve të tij, familjes së tij, shokëve të tij, njerëzve të mirë që kanë kaluar e në vazhdim për atë që është bërë nijet. Mbyllja e hatmes së Kur’anit është në rregull, dhe e pëlqyer në fenë tonë.

3. Erdhi vjet një arab kur ishim në xhami të Kirasit, me rastin e vënies së gurit të parë në ndërtimin e kësaj xhamie

Thotë imam Shafiu (r.a):

“Është gjë e pëlqyeshme

me i këndu të vdekurit

diçka prej Kur’anit

dhe në qoftë se

e këndojmë krejt Kur’anin

është më mirë”.

të bukur, u plotësoftë e u zbukurftë me xhematë. Në muhabet e sipër arabi tha: Këtu kanë një bidat shumë të keq, që falin drekën ditën e xhuma mbas xhumasë!

“Disa arabë që vijnë me punë këtu në Shqipëri, nuk janë që kanë studiuar për hoxhë, por për inxhinierë, ekonomistë, mjekë, etj, mirëpo mbasi dinë arabishten e kanë marrë disa mësim te disa arabë në fe, flasin dhe guxojnë me gjyku pa dije, dhe unë i thashë shkurtimisht: “Ata, more djalë, nuk gabojnë. Më dëgjo: Në kohë të Profetit (a.s) mbylleshin në ditën e xhuma 9 xhamitë që ndodheshin atje, e vinin me dëgju ligjëratën (hytben) që mbante Profeti (a.s) dhe ajo rrugë vazhdoi gjatë sundimit të katër kalifëve për 30-vjet, bile edhe gjatë sundimit të Emevitëve dhe një kohë të gjatë të Abasitëve. Në kohë të prijësit Mehdi, ose afër tij filluan me u hapë vendet, u bënë dy xhamia. Në Bagdad për xhuma, më vonë u shtuan shumë xhami, siç po shohim edhe sot”.

E pyeta arabin: Çfarë fakti kemi që duhet me u falë më tepër se në një xhami, xhumanë? Tha: Zakoni. Unë i thashë që zakoni nuk është fakt (argument) feje.

Prandaj kanë thënë dijetarët e kaluar, që po u fal xhumaja në një xhami, atëherë nuk falet dreka, por po qëlloi në një vend si Shkodra, ku falet xhumaja në disa xhamia, e nuk dihet se cila xhuma është falë përpara, si drekë rezervë falim drekën mbas xhumasë se ndoshta Zoti (xh.sh) nuk pranon më tepër se një Xhuma në një vend, siç ka qenë puna në kohë të Profetit (a.s) e të kalifëve, siç e përmendëm edhe më lart. Këtu arabi nuk foli, por nuk tha që e paskan të drejtë, se qenka punë që s’e kemi dëgjuar ose mësuar përpara.

Shumë gjëra i mohon njeriu, pa dije, kur e mëson, e din të vërtetën, por ai mohim nuk humbet tek Zoti (xh.sh),

mbasi është folur pa dije, ku duhet me pyet ai që nuk di.

4. Janë mësuar myslimanët këtu dhe në krejt vendet myslimane me ndërmjetësu Profetin (a.s) në një kërkesë para Zotit (xh.sh) ku thonë: “O Zot, ndërmjetësoje Profetin (a.s) të më shërosh të sëmurin”. P.sh, disa që kanë ardhur nga jashtë për të punuar këtu, kanë një doktrinë me disa mendime të veçanta, si dhe disa të rinj që po studiojnë në ndonjë vend arab, të dy këto grupe po e numërojnë këtë gjë si Bidat, që ndofta mbërrin në qyfer (mosbesim).

Pse? Pse thonë ashtu e akuzojnë baballarët tanë e hoxhallarët me qindra vjetësh që janë këtu e në vende të tjera myslimane!

Është një hadith i saktë, i cili tregon se ata me të vërtetë akuzojnë besimtarët pa dije, pa fakte, veç çka kanë dëgjuar prej dikujt.

Erdhi një qorr (i verbër) te Profeti (a.s) një ditë dhe iu ankua se u qorrua e nuk gjen kënd që ta ndihmojë. Profeti (a.s) i tha: Shko e merr abdes dhe fal dy rekatë nafle, mandej këndo këtë dua: “O Zoti im, të pyes e të parashtrohem me Pejgamberin tënd Muhammedin. O Muhammed, unë i parashtrova Zotit me ndërmjetësinë tënde në kërkesën time, pra pranoje ndërmjetësinë e Muhammedit

për me më plotësu kërkesën time!”. (Transmetuar nga Tirmidhiu)

Ky është hadith i saktë, siç kanë thënë shumë dijetarë dhe Ibni Tejmije. Ashtu u shërua ai qorri dhe i erdhi pamja si përpara. Por, Ibni Tejmije i veçuar nga dijetarë të tjerë ka thënë se Profeti (a.s): I ka bërë dua atij. Mirëpo ky kuptim i Ibni Tejmijes del gabim kur përmendet ky hadithi, që e ka përmendur Tabaraniu e kanë thënë dijetarët se është hadith i saktë.

Tregon Osmani, djali i Hunejfit, se iu ankua një ditë një shok se paska një nevojë te kalifi hz. Osmani (r.a), mirëpo ai thua se kishte harruar. I tha Osmani: “Unë tash po hyj te hz. Osmani e i tregoj çështjen tënde, mirëpo ti merr abdes, fal dy rekatë dhe bën duanë që përmenda më sipër”. Ai nevojtar bëri çfarë e mësuan, pastaj erdhi te kalifi hz. Osmani, e ai, porsa mësoi për ardhjen e tij, e mori në vendin e vet, u interesua për çështjen që kishte, ku i tha: “E kisha harruar kërkesën tënde”. Ia kreu kërkesën, mandej i tha: “Kur të kesh nevojë tjetër, eja përsëri tek unë”.

Kur doli ky nga vendi i hz. Osmanit, shikoi shokun e vet Osmanin, të cilin e falënderoi se gjoja fjala e tij me kalifin hz. Osmanin ia kreu atë nevojë. Ky i tha: Jo, unë ende nuk pata shkuar tek hz. Osmani, mirëpo pashë atë qorrin që kërkoj nga

Profeti (a.s) me ia kthye sytë, e se ai Zotni (a.s) e mësoi me marrë abdes, me falë dy rekatë, me lexu atë dua që ta mësova, mbasi ai qorri u shërua thashë që edhe ty të kryhet kërkesa ashtu me të mirën e Zotit (xh.sh).

5. Disa të tjerë thonë për disa gjëra: Nuk bën ajo gjë se Profeti (a.s) nuk e ka bërë atë. Ne i përmendëm disa shembuj për punën që kanë shpikur disa sahabë dhe disa prej tyre Profeti (a.s) e pëlqeu shpikjen e tyre dhe disa të tjerëve jo, në bazë të atyre gjërave që përmendëm më sipër. Mos bërja e një gjëje nga Profeti (a.s), ose mos folja e një fjale nuk është fakt në vete, derisa të dihet se ka ndaluar një gjë e atëherë ajo gjë ndalohet.

Ne pamë se kur i tha Zejdi Ebu Bekrit: Si mundesh të bësh një gjë që s’e ka bërë Profeti (a.s), kur kërkoj Ebu Bekri prej tij për me mbledhë Kur’anin, ai iu përgjigj: Është gjë e mirë dhe Zejdi e pranoi këtë gjë. Dhe më të vërtetë qe një gjë e mirë, se u mbrojt Kur’ani, megjithëse Profeti (a.s) nuk e mbloodi në jetën e vet Kur’anin në një libër, se ai, sa ishte gjallë, priste me iu zbritë, e mbasi vdiq ai Zotëri (a.s) atëherë u këput revelata (shpallja), d.m.th. përfundoi Kur’ani.

Nuk ka qene vetëm Haxhi urë e vazhdueshme e miqësisë me popullin Saudit, por edhe fakti i rëndësishëm historik se ky vend arab për disa dekada është drejtuar nga burra shqiptar, udhëheqës të njohur në botën arabe, si Muhamed Ali, i cili la gjurmë në zhvillimin social ekonomik të këtij vendi dhe më pas djali i tij i madh, Ibrahim Muhamed Ali, që ka qenë edhe disa vite vali i Mekës. Po në këtë vend arab, me emrin e Arabisë Saudite është lidhur veprimtaria historiko shkencore e arkitektit shqiptar nga Elbasani, Mimar Sinani, i cili ni vitet 1550-1570 arriti të ndërtojë dhe të projektojë me dhjetëra e me dhjetëra objekte fetare dhe social kulturore në Arabinë Saudite. Fama e arkitekt Sinanit është dhe sot në botën arabe. Xhami dhe medrese të ndërtuara në Mekë janë edhe sot tregues për aftësitë e larta shkencore të arkitekt Sinanit në vitet kur drejtoi shqiptari i famshëm Muhamed Ali dhe djali i tij Ibrahim, ku fituan një simpati të madhe tek fiset arabe. Ata u dalluan për korrektësi me të gjithë fiset, në veçanti treguan korrektësi në pagesën për hurmat, që blinin për ushtarët, për ujin e pijshëm si dhe mallrat e tjerë që blinin për interes të ushtrisë. Haxhillëku i shqiptarëve vazhdoi dhe kjo i jepte mundësi të takoheshin me ulema arabë.

Është fakt që një gazete siriane, Al Muktabaz në Tetor të vitit 1912 shkruante se çdo vit nga Damasku i Sirisë nisej një numër i madh shqiptarësh, por këtë vit nuk po shkojnë në Haxh, sepse morën lajmin për copëtimin e atdheut të tyre. Ata lanë rrugën e Haxhit duke thënë se, në Haxh mund të shkosh çdo herë sa je gjallë, por atdheu, Shqipëria mbrohet vetëm një herë nga copëtimi. Ky fakt historik është një tregues i lartë i ndjenjave të pastra patriotike të besimtarëve myslimanë shqiptarë, të cilët kanë pasur dhe kanë gjënë më të shtrenjtë mbrojtjen e interesave të larta të kombit, mbrojtjen e trojeve shqiptare.

Në fillimin e proceseve demokratike në Shqipëri, në periudhën e tranzicionit u gjend pranë nesh ndihma bujare nga popujt arabë, ne veçanti nga populli i Arabisë Saudite. Ne jemi dëshmitarë të atyre ndihmave të mëdha dhe të disa investimeve. Gjatë këtyre viteve në Shqipëri kanë ardhur shumë personalitete të Arabisë Saudite, si dhe sheikë të ndryshëm duke dhuruar



miliona dollarë, siç është rasti konkret për xhaminë “Ebu Bekr” në Shkodër etj.

Investime te fuqishme këto 20 vite marrin shifrën 780 milion dollarë të dhënë, investime nga Banka Islamike dhe vendet Arabe. Vetëm për rrugën Tirane –Elbasan janë dhënë 340 milion dollarë. Kontributi i Arabisë Saudite do të jetë i vazhdueshëm.

Po, kush është sot Arabia Saudite? Mbretëria e Arabisa Saudite është në njëzetëshen e shteteve më të zhvilluar të Botës, ajo e ka prodhimin e përgjithshëm industrial-bujqësor-blegtoral 186 miliard dollar. Ky tregues është i mjaftueshëm, sepse ajo eksporton mallra të ndryshëm me vlerë 57 miliard dollarë dhe importon 30 miliard dollarë, duke pasur një bilanc tregtar shumë pozitiv. Ky vend sot ka një popullsi prej 29 milion, ku përfshihen vendas arabë të ndryshëm dhe të punësuar nga të pesë kontinentet. Kryeqyteti i këtij vendi, Rijadi me rreth 4 milion banorë qendër e rëndësishme administrative dhe politike e botës arabe. Qytete të tjerë të rëndësishëm janë Meka, Medina si dhe Xhideja, një qendër e rëndësishme e komunikimit me botën, ku ngrihen rreth 430 aviona në ditë. Këto qytete me qiellgërvishtës të mëdha, me arkitekturën e tyre orientale dhe pak moderne, mbesin në kujtesën e çdo vizitori për madhështinë dhe bukurinë e tyre. Industria e fuqishme e naftës, ku me qindra vaporë nga të pesë kontinentet shpërndajnë naftën e cilësisë së lartë dhe ku me të drejtë Arabia Saudite është cilësuar gjiganti më i madh i naftës në botë duke arritur të shpërndajë deri ne 11 milion fuçi naftë në ditë.

Industria e prodhimit të makinerive me një teknologji bashkëkohore e bëjnë të njohur në të gjithë tregjet botërore. Edhe bujqësi-blegtoria kanë njohur zhvillime të jashtëzakonshme, kështu në këto vite është rritur 10 milion numri i dhenve, edhe pse shkretëtirat Saudite janë shumë të mëdha.

Shqipëria ka marrëdhënie te mira diplomatike dhe kërkon të rrisë bashkëpunimin ekonomik-kulturore. Për këtë do të kemi dhe përkrahjen e vazhdueshme të mbretit Selman Abdul-Azis. Shtrohet pyetja çfarë kontributi po jep Shteti Saudit në kalimin e krizës së madhe të njohur me emrin Pranvera Arabe? Shteti Saudit gjithmonë ka qenë përkrah ShBA si aleat i rëndësishëm dhe strategjik në luftë kundër çdo lloji terrorizmi.

Për dekada të tëra ajo është në luftë, jo vetëm kundër Alkaidës dhe të Isisit, por dhe të grupeve të tjera radikale Islamike që janë shfaqur edhe në tokën e Arabisë Saudite. Sot, në Ligën Arabe shihet kontributi konkret i Arabisë Saudite për vendet Arabe që janë pothuajse në lufte civile si: Iraku, Libia, Jemeni, dhe se fundi Siria. Përkrahja materiale dhe morale ndaj forcave demokratike në këto vende ka qenë shumë e rëndësishme për situatën e rëndë që krijoi Pranvera Arabe.

Në këtë përvjetor të 84-ët të Mbretërisë Saudite i urojmë popullit Saudit begati dhe suksese të mëtejshme.

*Kryetar i Shoqatës Miqësisë, Shqipëri-Vendet Arabe

(referat i mbajtur në Universitetin “A. Xhuvani”, Elbasan 23 shtator 2016)



Muamer Vuci

Kryetari Shoqatës, MSHVA*

Sot, populli i Arabisë Saudite feston me krenari të ligjshme festën kombëtare të shpalljes së Mbretërisë Saudite. Me këtë rast gjithë populli shqiptar i uron popullit mik arab të Arabisë Saudite suksese më të mëdha me fuqizimin ekonomik dhe begatinë e vendit.

Ne shqiptarëve na lidh një miqësi historike dhe tradicionale me të gjithë popujt arabë, në veçanti me popullin Saudit. Për ne emri i Arabisë Saudite

ARABIA SAUDITE NË NJËZETËSHEN E SHTETEVE MË TË ZHVILLUARA TË BOTËS, SOT NË FRONTIN KRYESOR KUNDËR TERRORIZMIT

është i lidhur me fillimet e shekullit 16, kur për haxhillëk filluan të shkojnë edhe shqiptarët nga të gjitha viset. Haxhillëku është një obligim i madh dhe i vazhdueshëm edhe për myslimanët shqiptar, sepse siç dihet ai është një nga pesë shtyllat e fesë islame.

Gjate këtyre 500 viteve, që nga vizitat e para të shekullit 16 dhe deri sot e kanë vizituar me mijëra e mijëra shqiptarë nga të gjitha trojet duke shkuar si haxhilerë. Shkuarja ne Haxh është konsideruar një festë e madhe për çdo qytet të Shqipërisë, si Shkodër, Elbasan, Durrës, Prishtinë, Shkup etj, ku ato përcilleshin me ceremonira të ndryshme nga mbarë besimtarët.

Të tilla festime janë fiksuar edhe tek fotografi Marubi në qytetin e Shkodrës, ku në pazarin e vjetër, apo tek Namazgjaja e Elbasanit behej

nisja për Haxh. Sot dokumentet në fototekën Marubi janë dëshmi e gjallë e asaj tradite që po ruhet dhe sot. Vërtetohet se shumë nga këto besimtarë sakrifikonin edhe pasurinë, dhe në raste të veçanta dhe jetën për të bërë rrugën e vështirë të haxhillëkut, e cila kalonte detyrimsht nga tokat Siriane ku shoqëroheshin nga Amir Arnaut (udhëheqës shqiptar) për në tokën e shenjtë të Mekës. Vetëm në vitet 39-91 kemi ndërprerje për arsye të luftës së Dytë Botërore, ashtu dhe pengesa nga regjimi komunist. Por me fillimin e dhjetorit te këtij shekulli u ulën në aeroportin e Rinasit avionët e fuqishëm Saudit dhe marrin falas për Haxh qindra besimtarë shqiptarë nga Shqipëria dhe Kosova, dhuratë e mbretit Fahd për Kombin Shqiptar, që hyri tani në rrugën e Demokracisë.



Naim Drija

imam, xhamia Parrucë

Disa nga objektivat, që duhet të ketë myslimani në jetën e tij, janë:

1. Ta jetojë Islamin në të gjitha aspektet e jetës. Ebu Dherri (r.a) e ka pyetur Pejgamberin (a.s): O i Dërguari i Allahut më trego një vepër, që nëse e veproj do të fitoj xhenetin. Profeti (a.s) i tha: “Besimi në Allahun”. Ebu Dherri (r.a) pyeti: Imani a kërkon vepra? Pejgamberi (a.s) i dha disa alternativa të veprave të imanit, që përfshijnë aspekte të ndryshme prej jetës së besimtarit, se si ta jetojë Islamin:

- “Le të japë prej pasurisë, që Zoti i ka dhënë”. Ebu Dherri pyeti? Po nëse është i varfër? Profeti (a.s) i dha mundësinë tjetër:

- “Të flasë mirë me gjuhën e tij”. Ebu Dherri e pyeti: Po nëse personi është memec, pa gojë?

- “Le të ndihmojë një person, të cilit i është bërë zullum”. Ebu Dherri pyeti? Po nëse personi është i dobët, nuk ka forcë për ta ndihmuar?

- “Le të ndihmojë të paafin në punën e tij”. Ebu Dherri pyeti? Po nëse personi është vetë i paafët dhe se ka asnjërin prej këtyre mundësive? Pejgamberi (a.s) i thotë: “Atëherë, të mos i bëjë keq njerëzve”.¹ Nëse muslimani nuk ka mundësi të bëjë të mira, të paktën, të mos bëjë keq.

2. Reflektimi i mësimave të islamit në jetë. Zoti (xh.sh) e ka dërguar Profetin (a.s) më misionin e mëshirës. Ne si besimtarë, sa e reflektojmë mëshirën në jetën tonë? Allahu (xh.sh) thotë: “Ne, nuk të dërguam ty (Muhammed), vetëm se mëshirë për të gjitha botët.”² Duke komentuar ajetin e lartpërmendur, Imam Razi në tefsirin e tij thekson: “Muhamedi (a.s) ishte mëshirë në fe dhe mëshirë në këtë botë. Mëshirë në fe, sepse ai (a.s) u dërgua, ndërkohë që njerëzit jetonin në injorancë dhe humbje. I ftoi në të vërtetën, u shpjegoi

MISIONI I MYSLIMANIT NË JETËN E TIJ

atyre rrugët e shpërblimit dhe u qartësoi atyre vendimet, duke bërë dallimin në mes hallallit dhe haramit. Mëshirë në këtë botë për faktin se ata shpëtuan për shkak të tij nga shumë poshtërime, luftëra dhe vrasje, si dhe triumfuan për shkak të fesë së tij”.

Në momentet më të rënda, në luftën e Uhudit, kur idhujtarët u munduan ta vrisnin Pejgamberin (a.s) dhe e detyruan të drejtohet drejt një kurthi, një grope të hapur. I rrethuar nga të gjithë anët me armiq Pejgamberi (a.s) u plagos rëndë aq sa u dëmtua në fytyrën e bekuar, që ia mbuloi gjaku dhe iu thyen dy dhëmbët e përpamë. Sahabët u zemëruan dhe i thanë: “Lutu kundër tyre (idhujtarëve) o i Dërguar i Allahut”, ndërsa ai iu përgjigj: “Unë nuk jam dërguar për të mallkuar, por vetëm mëshirë”.

Ai i ngriti duart nga qielli, dhe njerëzit që e panë duke vepruar ashtu menduan se Profeti (a.s) do t'i mallkonte idhujtarët, ndërsa nga goja e tij e bekuar dolën fjalët: “Zoti im! Fale, udhëzoje popullin tim, sepse ata nuk e dinë seç po veprojnë”.

3. Synimi ynë duhet të jetë afrimi i njerëzve nga feja, jo nxerrja e tyre prej saj. Allahu (xh.sh) thotë: “Elif Lam Ra. Këtë Libër ta kemi shpallur ty (o Muhamed), për t'i nxjerrë njerëzit, me lejen e Zotit të tyre, nga errësira në dritë, në rrugën e të Plotfuqishmit, të Denjit për çdo lavdi”.³

Njëherë, Profetin (a.s) e pyetën: “Cila është ajo punë, që njerëzit i fut më shumë në xhenet?” Profeti (a.s) iu përgjigj: “Frika nga Allahu dhe morali i lartë”.⁴

4. Misioni ynë duhet të jetë lehtësimi dhe mësimi i njerëzve fenë e Zotit. Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Në të vërtetë, Allahu nuk më ka dërguar shkatërrues dhe vështirësues, por më ka dërguar mësues dhe lehtësues.”⁵

5. Shfrytëzimi i mundësive për të bërë vepra të mira. I Dërguari i Allahut ka thënë: “Ruajuni Zjarrit, qoftë edhe me gjysmë hurme, ose edhe me një fjalë të mirë.”⁶ Allahu (xh.sh) thotë: “Kush ka bërë ndonjë të mirë, qoftë sa një thërmijë, do ta shohë atë, e kush ka bërë ndonjë të keqe, qoftë sa një thërmijë, do ta shohë atë.”⁷

Ebu Hurejra (r.a) transmeton se i Dërguari (a.s) ka thënë: “Një njeri duke udhëtuar e kishte lodhur etja e madhe,

gjen një pus dhe zbret poshtë e shuan etjen. Kur del jashtë sheh një qen, që kishte nxjerrë gjuhën jashtë dhe hante dhë nga etja. Atëherë mendoi me vete e tha: Kjo krijesë ndihet e etur, ashtu siç ndihesha unë pak më parë. Zbret përsëri në pus, mbushë me ujë këpucën e tij dhe ngjitet e ia jep qenit. Allahu për këtë e shpërbleu dhe ia fali gjynahet.”⁸

“Një grua u ndëshkua për shkak të një maceje. Ajo e mbylli atë derisa ngordhi nga uria. As nuk e ushqeu dhe as nuk e la të lirë të ushqehet vetë.”⁹

6. Adhurimi i Zotit, pasimi i Profetit (a.s) dhe dashuria ndaj Tij. Është misioni më kryesor në jetën e muslimanit. Allahu (xh.sh) thotë: “Xhinët dhe njerëzit i kam krijuar vetëm të Më adhurojnë”¹⁰, “Adhuroje Zotin tënd derisa të të vijë vdekja.”¹¹

Enes ibn Maliku (r.a) tregon se një njeri e ka pyetur Pejgamberin (a.s): Kur do të ndodhë Dita e Kiametit? Pejgamberi (a.s) i tha: “Çfarë ke përgatitur për Ditën e Kiametit?” Ai iu përgjigj: Për Ditën e Kiametit nuk kam përgatitur shumë gjëra, me përjashtim të obligimeve, por e dua Allahun dhe të Dërguarin e Tij. Pejgamberi (a.s) i tha: “Ti do të jesh në botën tjetër së bashku me atë që e do.”¹²

Një burrë prej ensarëve shkoi te Profeti (a.s). Shenjat e mërzitjes dukeshin qartë në fytyrën e tij. I Dërguari i Allahut (a.s) i thotë: “O filan, më dukesh mjaft i mërzitur, çfarë të shqetëson?” Ai ia ktheu: O i Dërguar i Allahut, u shqetësova kur mendova për diçka. “E për çfarë mendove?” – i tha Profeti(a.s). Ai tha: Ne shkojmë e vijmë dhe ti je pranë nesh. E shohim fytyrën tënde dhe bisedojmë me ty. Ndërsa nesër ti do të bashkohesh me Profetët. Ne nuk do të arrijmë dot ty, dhe nuk do të të shohim më!” Profeti (a.s) heshti dhe nuk tha asgjë.

Pas pak zbriti Xhibrili (a.s) me fjalën e Allahut: “Kushdo që i bindet Allahut dhe të Dërguarit, do të jetë me ata, të cilëve Allahu u ka dhënë shumë dhunti: Me profetët, me të sinqertët, me dëshmorët dhe me të drejtët. Eh sa shoqëri e mrekullueshme janë këta!”¹³ Pastaj Profeti (a.s) dërgoi një lajmëtar, që ta përgëzonte ensariun me këtë ajat.

8. Transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi.

9. Transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi.

10. Kur'ani, Edh-Dhariyat: 56.

11. Kur'ani, El-Hixhr: 99.

12. Transmetuar nga Buhariu.

13. Kur'ani, En-Nisa: 69.

I NDERUARI ISLAM KAZMA, I PALODHUR NË SHËRBBIM TË BESIMIT...

PEJGAMBERI (A.S) KA THËNË:

“KUSH UDHËZON PËR NJË VEPËR TË MIRË, AI KA SHPËRBLIMIN E ATIJ QË E KA KRYER ATË VEPËR”

Në xhaminë e Rusit, ku shërbej prej vitesh, në ditët e xhuma, kanë ardhur dhe vijjnë jo vetëm xhemati i përhershëm, por edhe besimtarë dhe besimtare nga lagje dhe fshatra të ndryshëm. Një prej ditëve të bekuara të xhumasë, në momentin që po ulesha në kursij për të bërë ders, vërej një burrë të moshuar, por i fortë, me trup të gjatë, i këndshëm, fisnik dhe që në pamje të parë të jepte përshtypjen e një besimtari të vërtetë dhe të devotshëm.

M'u duk se e njihja prej vitesh, por nuk mund ta përcaktoja prej nga ishte dhe kush ishte. Pas faljes së namazit, kur besimtarët po dilnin nga xhamia, ky zotëri i këndshëm u afrua drejt meje dhe foli disa fjalë që më pëlqyen. E pyeti për identitetin e tij dhe prej nga ishte dhe ku jetonte. Ai me buzë në gaz, u përgjigj, sikur po më thonte: A nuk më mbanë mend? Quhej Islam Kazma, nga Grizha e Malësisë së Madhe.

Dashje pa dashje më nxiti kurioziteti dhe interesimi për këtë njeri. Bisedat e tij më zbulonin thellësitë e mendimeve dhe përvojave të jetës. Zellin e tij, përkushtimin e shpirtin e pasur besimtar dhe adhures ndaj Allahut (xh.sh), dashurinë për Pejgamberin (a.s) dhe fenë islame.

Islami kur dëgjon këndimin e Kur'anit, kur dëgjon hadithet e Pejgamberit (a.s) zemra i dridhet dhe i duket sikur del prej gjoksit e i ngjitet lartësive. Lotët i rrjedhin nga sytë ndër faqet e bardha të tij.

Ai, si i ka të arta fjalët e tij, po ashtu i ka edhe veprat, e megjithë moshën e thyer që ka, ajo nuk e pengon.

Islam Kazma dëshiron të dijë shumë për besimin islam, mbasi ato çfarë ai ka mësuar i duken pak. Ai thotë: Jam i etur për të mësuar. “Edhe pse jam në moshë, jam i gatshëm të bëj çdo sakrificë që kërkohet nga feja islame!” Ai sa herë vjen për të falur xhumanë, por edhe ditëve të tjera, pyet për shumë çështje të ndryshme fetare, në mënyrë që të mësojë sa më shumë rreth besimit dhe fesë.



veçanërisht xhematit të xhamisë së Grizhës. Sa punë e lavdërueshme të jesh shërbëtor i thjeshtë dhe i pa fjalë në përhapjen e Fjalës së Allahut!

Duke menduar këtë punë të lavdërueshme dhe të tjera si kjo, që bën besimtari i nderuar Islam Kazma, them me vete: Sa mirë dhe frytdhënëse, që shembulli i këtij besimtari të jetë te çdo njeri, sa përpara do të ishim në rrugën e besimit, sa rregull e jetë të mbarë do të gëzonim dhe mbi të gjitha sa afër do të ishim tek Zoti i Madhuar,

sepse Ai që na krijoi dhe na udhëheq meriton të bëjmë sa më shumë për përhapjen e Fjalës së Tij dhe dritën e besimit.

Z. Islam Kazma, i uroj jetë të gjatë dhe pleqëri të mbarë, e të vazhdojë punën e lavdërueshme që po bën duke qenë shembull për të tjerë dhe brezat e ardhshëm.

Haxhi Fejzi Zaganjori

(imam, xhamia Rus)


NDËRROI JETË HAXHI ESAT DINI, MUEZINI I TOPHANËS

Para disa ditëve ndërroi jetë një prej vëllezërve tanë besimtarë, burri i urtë, i dashur, i qeshur, gojëmbël, fjalëpak e punë shumë, Haxhi Esat Dini, i cili për 25 vite rresht, iu përkushtua fesë islame me të gjitha aftësitë dhe mundësitë e tij.

Të themi sado fjalë të bukura për Haxhi Esatin nuk mundemi ta përfshijmë në çdo detaj punën e tij të palodhshme për t'i shërbyer Myftinisë Shkodër, besimtarëve nëpër xhamia, si në atë të Parrucës dhe Tophanës. Ai u

për dashurinë ndaj Profetit Muhammed (a.s), për mësimin e Kur'anit Famëlartë dhe këto ai i pati bashkudhëtar në të gjitha etapat e jetës, derisa e dorëzoi shpirtin.

Haxhi Esati ka kryer detyrën e muezinit që nga viti 1991, fillimisht në xhaminë e Parrucës, pastaj në xhaminë e Tophanës. Ai qe i përkushtuar dhe njëherë ai bashkëpunoi me kolegët e tij, si Xhevdet Kruqi, Eljaz Zejnuni, Syrri Myrtja, të cilët nuk jetojnë më, e rahmeti i Zotit qoftë mbi të gjithë këta, si dhe me H. Daut Shabaj, H.



H. Esat Dini

*PEJGAMBERI (A.S)
KA THËNË: "SIKUR
TA DININ NJERËZIT SE,
ÇFARË (SHPËRBLIMI) KA NË
THIRRJEN E EZANIT DHE NË
SAFIN (RRESHTIN) E PARË
(NË NAMAZ), ATËHERË
NUK DO TË KISHIN GJETUR
ZGJIDHJE PËR TË, VEÇSE
TË HEDHIN SHORT".*

(BUHARIU DHE MUSLIMI)

Myftinia Shkodër humbi muezinin aktivist të palodhur dhe shembullor, ndërsa muezinët një mik dhe bashkëpunëtor të afërt të tyre, xhemati i Tophanës një vëlla besimtar të dashur dhe të respektuar. Familja humbi prindin dhe bashkëshortin e sjellshëm, të edukuar, në familjar me të gjitha cilësitë fetare islame, morale e qytetare, Tophana banorin e saj të nderuar dhe qytetarin e denjë.

Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari humbi mikun e dashur, që e donte dhe e nderonte. Në momentin e faljes së xhenazes në Tophanë, ai bëri lutje për shpirtin e tij nga Qabja e Madhërueshme, pasi ishte në haxh.

Allahu (xh.sh) i pranoftë veprat e tij në shërbim të fesë, shoqërisë dhe mbarë besimtarëve. Rahmeti i Tij qoftë i përhershëm dhe u shpërbleftë me xhenetin Firdeus. Amin!

Haxhi Fejzi Zaganjori

Xhamia Tophanë, 2009



mishërua me xhaminë dhe besimtarët, saqë në çdo çast ishte i gatshëm për të kryer çdo punë.

Haxhi Esati ishte një veprimtar izellshëm, një njeri i thjeshtë, që nuk kundërshtonte asgjë, por çdo punë e bënte për hatër të Allahut (xh.sh).

Haxhi Esat Dini është tashmë në jetën e vërtetë, por sa më shumë do të kalojnë vitet, aq më tepër do të dritësohet fisnikëria, dashuria, devotshmëria dhe sineriteti i tij, si një besimtar i denjë tek i Madhi Zot dhe për dashurinë për Hazreti Muhammedin (a.s). Për Haxhi Esatin, respekti dhe dashuria për njerëzit si dhe mohimi i gjërave të pavlera ishin pjesë përbërëse dhe dominuese e qenies së tij.

Ai që në fëmijëri u mëkua nga familja për besimin tek Zoti (xh.sh),

Qemal Tafli, Sheuki Dibra, të cilëve Zoti i Madhëruar i dhuroftë jetë dhe shëndet të plotë.

Të gjithë këta burra besimtarë shpejtonin për të kryer detyrën e muezinit me shumë korrektësi. Haxhi Esati nuk u ankua asnjëherë për kohën dhe mundin e harxhuar, edhe pse pa asnjë shpërblim, vazhdoi të punojë derisa nuk ishte në gjendje të mirë shëndetësore.

Ai ishte model për muezinët në të gjithë veprimtarinë e tij, ishte zbatues rigoroz i detyrës së tij dhe zbatues i saktë i rregullores së xhamisë. Haxhi Esati ishte shumë i sjellshëm, një njeri që nuk trazonte askënd. Ishte një mik i gjithkujt dhe i përpiktë në çdo drejtim.

Haxhi Esat Dini mbetet shembull i mirë për njerëzit e besimit dhe për muezinët e ardhshëm.

RRUGË TË MBARË, HAXHILERË TË SHKODRËS!

Ditën e xhuma, më 2 shtator 2016, në prani të qindra besimtarëve, në xhaminë e Parrucës u zhvillua ceremonia e përcjelljes së haxhilerëve të Shkodrës për vitin 1437/2016.

Ceremonia u hap nga teologu Arben Halluni, i cili i uroi mirëseardhjen haxhilerëve të këtij viti, familjarëve të tyre, që kishin ardhur për t'i përcjellë dhe gjithë besimtarëve të pranishëm.

Më pas e mori fjalën Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, i cili me këtë rast përshëndeti haxhilerët dhe në këtë fjalë përshëndetëse, ndër të tjera tha: "Ju Haxhilerë të shtrenjtë jeni delegatë të Allahut dhe miqtë e Tij. Allahu i Madhëruar ju ka zgjedhur të jeni përfaqësuesit e këtij qyteti për këtë vit drejt vendit më të shenjtë të botës, Qabes së Madhnueshme, prandaj mos e harroni në duatë tuaja, vendin, vëllezërit e motrat dhe gjithë besimtarët e qytetarët, duke ju lutur All-llahut për mbarësi e begati".

Pastaj, Myftiu i Malësisë së Madhe, H. Edmir Smajlaj, me këtë rast mbajti një këshillë të vlefshme për haxhilerët e Shkodrës dhe të Malësisë së Madhe. Ai ndër të tjera theksoi se haxhiu, që ka bërë njet të kryejë obligimin e haxhit duhet të ketë parasysh që njet i tij të jetë i pastër, vetëm për hir të Allahut, të shlyejë çdo detyrim moral e material, që mund të ketë ndaj ndonjë personi, qoftë i afërt, apo i largët dhe të shfrytëzojë në maksimum kohën gjatë ditëve të qëndrimit në haxh, qoftë gjatë kryerjes së riteve të haxhit, por edhe gjatë vizitave të ndryshme të vendeve të tjera të shenjta, si në Medinën e Resulull-llahut, në Uhud, në xhaminë Kuba etj.



Pas fjalës së dy myftilerëve, u bë shpërndarja e pasaportave dhe ihrameve, si dhe e literaturës ndihmëse për haxhilerët, në mënyrë që t'u ndihmojë në lehtësimin dhe kryerjen sa më mirë të riteve të haxhit. Me emocione të shumta u lexuan emrat e të gjithë haxhilerëve të këtij viti, duke marrë në dorë ihramin, veshjen tradicionale të haxhiut, e cila do t'i shoqërojë gjatë kryerjes së riteve të haxhit.

Me hyrjen e kohës së ezanit, u bë thirrja e tij për namazin e xhumasë dhe hytben e kësaj dite e mbajti Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari. Myftiu foli për rëndësinë e përgjigjes së thirrjes së All-llahut për të kryer obligimin e haxhit, thirrje e cila u bë nga i dërguari i All-llahut, Ibrahim (a.s). ndër të tjera, Imam Sytari këshilloi haxhilerët, që të mos harrojnë të luten për vendin e tyre, sidomos në këtë periudhë të vështirë, ku janë përhapur islamofobia, ateizmi, shturja morale, padrejtësia e të tjera vese. Ai u

lut për haxhilerët dhe gjithë besimtarët, që Allahu t'i përfshijë në mëshirën dhe faljen e Tij të përgjithshme.

Pasi u fal namazi i xhumasë, menjëherë u bë përshëndetja me haxhilerët dhe nisja e tyre për në aeroport, të shoqëruar nën zërin e telbijeve "Lebbejkell-llahumme lebbejk."

Këtë vit u nisën 44 haxhilerë, 38 nga Shkodra dhe 6 nga Malësia e Madhe. Për haxh këtë vit u nis edhe Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, i cili do të jetë bedel për një plakë të fisnike shkodrane, e cila kishte kërkuar më parë që haxhin e saj, ta kryente Myftiu i Shkodrës.

Haxhilerët e Shkodrës do të kenë si murshid (udhëzues) teologun Ruzhdi Plangaj, imam i xhamisë së Kirasit dhe teologun Ferzet Ndoja, si murshide për gratë haxhilere.

Myftinia Shkodër uron të gjithë haxhilerët e Shkodrës, Shqipërisë dhe mbarë ymetit, Haxh të pranuar!



TEKBIRI MBULOI SHKODRËN NË NJË DITË TË DËSHMUAR



Ditën e hënë, më 12 shtator 2016, që herët në mëngjes, xhamitë e Shkodrës janë nisën të gjallërohen me tekbirot e mijëra besimtarëve, të cilët kishin tejmbushur xhamitë me praninë e tyre, duke iu përgjigjur thirrjes së Zotit të Madhëruar, për të kryer faljen e namazit të sahabut, së bashku me faljen e namazit të Kurban Bajramit.

Kjo ditë e bekuar, që e ka zanafillën prej nga babai i të profetëve, Ibrahim (a.s.), vjen si përkujtim i bukur i kësaj sakrifice, që rob i bën për Krijuesin e tij, Zotin e gjithë botëve.

Pa dyshim, që festa e Kurban Bajramit është edhe solidaritet dhe gëzim që i bashkohet mijëra e miliona haxhilerëve anekënd botës, të cilët kanë shkuar për të kryer një nga shtyllat kryesore të Islamit, obligimin e Haxhit.

Myslimanë nga e gjithë bota, pa dallim ngjyre dhe race, kombësie dhe gjinie, me bindje dhe besimin e plotë, i janë përgjigjur thirrjes së Zotit të Madhëruar, duke thënë: "Lebhejke Allahumme Lebhejke" (Tu përgjigja Ty o Zoti im, tu përgjigja).

Për efekt të motit të paqëndrueshëm, ceremonitë zyrtare u zhvilluan në dy xhamitë kryesore të qytetit të Shkodrës, përkatësisht në xhaminë "Ebu Bekër", nën drejtimin e teologut Lavdrim Hamja dhe imamit të kësaj xhamie, teologut Idmir Plaku. Ata kanë folur për rëndësinë besimit, se përse duhet që njeriu të besojë dhe veçanërisht për simboliken

e kësaj dite të sakrificës, ditës së Kurban Bajramit.

Namazi i sabahut në xhaminë "Ebu Bekër" u fal nën drejtimin e imamit Lavdrim Hamja, ndërsa namazin e Kurban Bajramit dhe hytben e tij, e kreu imam Idmir Plaku.

Ndërkohë në xhaminë e Parrucës, këtë ceremoni e drejtonin teologu Arben Halluni dhe imami i kësaj xhamie, Naim Drijaj. Përmes ligjëratave të tyre, dy teologët kanë hedhur dritë rreth parimeve dhe mësimëve të Islamit, si fë e paqes, harmonisë, tolerancës, bashkëpunimit, dijes dhe e çdo cilësie tjetër fisnike.

Në xhaminë e Parrucës namazi i sabahut u fal nën drejtimin e imamit Naim Drijaj, i cili gjithashtu kreu edhe hytben e Kurban Bajramit, ndërsa namazin e Kurban Bajramit e fali teologu Arben Halluni.

Gjithashtu Imamët kanë falënderuar besimtarët për kontributet e tyre, për ndihmën ndaj nevojtarëve dhe të varfërve dhe angazhimin për të përmirësuar ditë pas dite shfaqjen e tyre në shoqëri, si themel i saj.

Edhe në të gjitha xhamitë e tjera të Shkodrës, ceremonitë e Kurban Bajramit u zhvilluan rregullisht, duke dëshmuar mirësitë dhe begatitë e kësaj dite të madhe, feste dhe adhurimi.

Me përshëndetjet më të ngrohta, me lutje dhe dua për njëri-tjetrin dhe me tekbirot të shumta, besimtarët janë uruar në mes vete duke marrë kënaqësinë dhe mirësinë e kësaj dite të begatë.



Pejgamberi (a.s) ka thënë:

"Kush sjell një traditë të mirë në Islam, ai ka shpërblimin e saj dhe shpërblimin e atyre që e punojnë atë traditë, pa iu pakësuar gjë prej shpërblimit të tyre. Dhe kush sjell një traditë të keqe në Islam, ai ka gjynahun e saj dhe gjynahun e atyre që e punojnë atë traditë, pa iu pakësuar gjë prej gjynahut të tyre."

(Transmetuar nga Muslimi)

VIZITAT E LARMISHME TË KURBAN BAJRAMIT 1437/2016



Ditën e hënë, më 12 shtator 2016, nga ora 9-11 paradite, Myftinia Shkodër, organizoi në xhaminë e Parrucës pritjen tradicionale me rastin e festës së Kurban Bajramit. Në këtë pritje të ngrohtë, merrnin pjesë anëtarë të kështillit të Myftinisë dhe imamë të Shkodrës, të cilët nën drejtimin e teologut Arben Halluni, pritën miqtë dhe besimtarët e shumtë, të cilët erdhën për të uruar këtë ditë të madhe feste dhe adhurimi.

Të parët që uruan ishin përfaqësuesit e komuniteteve fetare, katolikë dhe ortodoks, të cilët përcollën urimet e tyre dhe të besimtarëve përkatës, duke uruar gjithë mysliamanët festën e Kurban Bajramit. Ata theksuan se shqiptarët dhe sidomos shkodranët e kanë traditë urimin e festave të njëri-tjetrit, duke u lutur që paqja, toleranca dhe harmonia të mbretërojë gjithmonë në mesin e mbarë njerëzimit.

Gjithashtu edhe drejtues të pushtetit lokal, të Bashkisë, të Qarkut dhe të Prefekturës, por edhe drejtues të partive politike, uruan gjithë mysliamanët me rastin e kësaj dite të madhe sakrifice dhe adhurimi për mbarë besimtarët

mysliamanë. Ata shprehën konsideratën e tyre për kontributin e institucionit të Myftinisë Shkodër dhe të mysliamanëve shkodranë për harmoninë dhe tolerancën, e cila ekziston në qytetin tonë dhe në mbarë Shqipërinë.

Po ashtu, besimtarë të shumtë erdhën dhe uruan festën e bukur të Kurban Bajramit me urimet më të ngrohta dhe lutjet më të mira, për mbarësi dhe lumturi të gjithë besimtarëve mysliamanë dhe paqe, harmoni e tolerancë në mbarë botën.

Në emër të Myftiut të Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, (i cili këtë vit ndodhet në Haxh), të Myftinisë Shkodër dhe të gjithë besimtarëve, teologu Arben Halluni falënderoi të gjithë miqtë dhe besimtarët e shumtë, që uruan dhe morën pjesë në ceremoninë e festës së Kurban Bajramit, por edhe besimtarët, të cilët morën pjesë në organizimin dhe mbarëvajtjen e ceremonisë me rastin e kësaj dite feste, që nga falja e namazit të sabahut, falja e namazit të Kurban Bajramit dhe ceremonia e pritjes së miqve dhe besimtarëve.




Pejgamberi (a.s) ka thënë:

"Allahu është në ndihmën e robit të Tij, derisa rob i të jetë duke ndihmuar vëllanë e tij"

(Transmetuar nga Muslimi)



"Ti nuk e ke krijuar këtë botë
që t'ia imponosh të tjerëve kushtet tuaja.
Drejto së pari veten tënde
për të qenë shembull për të tjerët,
përpara se t'u kërkosh atyre,
që të jenë si ti!"



Dr. Mustafa Mahmud

Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

 
MYFTINIA SHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org